



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 223 regjistri

Nr. 91 vendimi

Dt. 06.11.2020



VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues të përbërë nga:

KASTRIOT SELITA - GJYQTAR
BARI SHYTI - GJYQTAR
ENKELEJDA METALIAJ (SOFTA) - GJYQTARE

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Valbona Zenelaj, sot më dt. 06.11.2020, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen administrative me palë:

PADITËS:

██████████, i biri i ██████████ dhe i ██████████ I dtl ██████████
lindur në ██████████ dhe banues në ██████████, Rr: ██████████ P.nr. ██████████ ap
██████████. Cel ██████████, përfaqësuar në gjykim nga av. ██████████
██████████

I PADITUR:

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me adresë rr. "Ibrahim Rugova, ndërtesa nr.20, 1001, përfaqësuar nga ██████████ dhe ██████████

PERSON I TRETË:

Avokati i Popullit, me adresë Rr ██████████, (në mungesë).

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me adresë Blv "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga ██████████

Komisioneri për Diskriminimin, me adresë Rr. Durrësit nr.27, Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga ██████████

Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut, përfaqësuar nga ██████████ me nr. cel ██████████

OBJEKTI:

Pavlefshmërinë e vendimit nr. 35, datë 09.10.2020 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (Këtu e në vijim referuar me inisialet KED) dhe shfuqizimin e tij.

Konstatimin e shkeljes së nenit 6, 8, 14, 17 të KEDNJ si rezultat i ndalimit të kandidimit për anëtar në GJK; Detyrimin e palës së paditur, KED të përfundojë procedurën për z. [REDAKTUAR] për vakancën e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.

BAZA LIGJORE:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nenet 15, 16, 17 e 125/4,5, 149/d e vijim; Ligji nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", nenet 226-238 e vijues; Vendimi nr.4 i KED-së, datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar; Ligji nr. 8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikës e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.96/2016, neni 7/a; Ligji nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative, i ndryshuar; Ligji nr.49/2012 "Për gjykatën administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar; Ligji nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"; Vendimi nr.11, datë 20.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë; Vendimi nr.60, datë 16.09.2016, etj Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut nenet 6 e vijim.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, Gjykata pasi mori në shqyrtim provat shkresore, dëgjoi dhe pretendimet përfundimtare të palëve, të cilat kërkuan:

Paditësi [REDAKTUAR] kërkoi: Pranimin Kërkesës, duke konstatuar Pavlefshmërinë e vendimit Nr. 35, datë 09.10.2020 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi "Për ndalimin e kandidimit të z. [REDAKTUAR] në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën, 22.11.2019". Detyrimin e palës së paditur, KED të përfundojë procedurën për z. [REDAKTUAR] për vakancën e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019". Ezaurimin e kriterit ndalues te integritetit të figurës duke parë rrethanat dhe mënyrën e votimit të KED.

Pala e paditur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kërkoi: Rrëzimin e padisë.

Përsoni i tretë, Presidenti i Republikës së Shqipërisë kërkoi: pranimin e padisë për shfuqizimin e aktit, ndërsa për lejimin e kandidimit e la në çmim të gjykatës.

Përsoni i tretë Komisioneri për Diskriminimin kërkoi; Si ta çmojë gjykata.

Përsoni i tretë Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut kërkoi; Pranimin e padisë.

Përsoni i tretë Avokati i Popullit: E la gjykimin në mungesë.

VËREN

Se, paditësi [REDAKTUAR], pasi është njohur me vendimin e marrë nga KED lidhur me kandidimin e tij për plotësimin e një vendi vakant në gjykatën Kushtetuese, brenda afatit ligjor, ka paraqitur padinë objekt i këtij gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit, duke kërkuar si në objektin e padisë.

Bazuar në rregullimin e posaçëm procedural, parashikuar nga neni 238 i Ligjit Nr. 49/2016, kjo gjykatë mori në shqyrtim çështjen brenda afatit ligjor prej 7 ditësh.

I. Rrethanat e Çështjes:

Raportuar aktëve të dosjes rezultojnë e provuar se:

1. Në zbatim të Nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të Nenit 7/b të Ligjit Nr. 8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë, Presidenti i Republikës, në datën 22.11.2019, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit [REDAKTUAR]. Një ndër kandidatët që ka shprehur interes për plotësimin e kësaj vakance ka qenë edhe paditësi [REDAKTUAR].
2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në Nenin 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000.
3. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar në datën 15.01.2020, nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në zbatim të Nenit 228 të Ligjit Nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 2 datë 15.02.2019 "Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion", si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4 datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, zonja [REDAKTUAR].
4. Zoti [REDAKTUAR], si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me Nr. 4 datë 11.03.2019, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës.
5. Në datën 20.01.2020, kandidati [REDAKTUAR] është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij.
6. Në datën 23.01.2020, kandidati [REDAKTUAR] ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij.
7. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës "dh" të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, të Nenit 235 të Ligjit Nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4 datë 11.03.2019, me shkresën Nr. 34 Prot., datë 30.01.2020, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit Nr. 8577/2000 dhe Ligjit Nr. 115/2016.

8. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe deklarata e nënshkruar nga kandidati [REDAKTUAR], ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

9. ILDKPKI, në zbatim të Nenit 235 të Ligjit Nr. 115/2016, të Ligjit Nr. 9049/2003 dhe Ligjit Nr. 9367/2005, me shkresën Nr. 1112/5 Prot., datë 06.03.2020, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin [REDAKTUAR] dhe personat e lidhur me të. Rezultatet e kontrollit janë të pasqyruara në shkresën nr. 129/26 Prot., datë 06.03.2020, gjithsej 18 faqe.

10. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarimin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit [REDAKTUAR] ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *Ka burime financiare të ligjshme për te justifikuar pasuritë;*
- *Nuk ka kryerfshehje të pasurisë;*
- *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *Kandidati nuk gendet në situatën e konfliktit të interesit.*

11. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të Nenit 229 dhe 235 të Ligjit Nr. 115/2016, të shkronjës "e" të pikës 20, 24, shkronjës "b" të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4 datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe te Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë", edhe Këshilli ka kryer veprimet verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit [REDAKTUAR] dhe personave të lidhur me të.

12. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatit [REDAKTUAR], Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 18.02.2020, i është drejtuar me kërkesa për informacion dhe ka marrë përgjigjet përkatëse me të dhënat e kërkuara nga secili prej institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit).

13. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidatin [REDAKTUAR].

14. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës "ç" të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, të Nenit 236 të Ligjit Nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4 datë 11.03.2019 "Perproceduren e verifikimit të kandidatëve për vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe te Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", me shkresën Nr. 35 Prot., datë 30.01.2020, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë

formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati [REDACTED] sipas Ligjit Nr. 138/2015.

15. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën Nr. 211/320 Prot., datë 03.06.2020, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin [REDACTED]. Kështu rezulton se me Vendimin "Përmiratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin [REDACTED] datë 04.06.2020 është vendosur ndër të tjera se:

- Nuk rezultoi të ketë kryer ndryshime në perberesit e gjendjes civile të ndryshme nga ato të deklaruara neformular;
- Subjekti deklarues [REDACTED] me vendim penal të forme-s së prerë Nr. 3170, date. 18.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është deklaruar i pafajshëm për kryerjen e veprës penale të "Drejtimin të mjetit në mënyrë teparregullt", parashikuar nga Neni 291 i Kodit Penal. Ai ka patur masë sigurimi personale "Detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", e cila është revokuar;
- Nuk rezultoi i dënuar me vendim të forme-s së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale nga autoritetet gjyqësore shqiptare apo të huaja;
- Nuk rezultoi i dënuar me vendim gjyqësor përfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të forme-s së prerë;
- Rezultoi që me date 09.04.2016 është arrestuar në flagrancë për kryerjen e veprës penale Drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt", parashikuar nga Neni 291 i Kodit Penal; Rezultoi që me Vendimin Nr. 958, datë 09.04.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë të ketë qenë i siguruar me masë sigurimi personal me karakter shtrengues "Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore, si person nën hetim",
- g) Nuk ka genë ndonjeherë në kërkim ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale;
- h) Nuk rezulton të ketë ardhur në Pikat e Kalimit Kufitar në Republikën e Shqipërisë si i deportuar nga një shtet i huaj.

16. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatis [REDACTED], në zbatim të shkronjës "ç" të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, të Nenit 236 të Ligjit Nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4 datë 11.03.2019, Këshilli i është drejtuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, dhe me kërkesë për informacion Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme .

17. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme ka dërguar përgjigje me shkresën Nr. 360/4 Prot., datë 09.09.2020, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin [REDACTED]

- Nuk janë të regjistruar nga strukturat e Policisë së Shtetit për veprimtari kriminale ose të administrohen të dhëna për kontakte të papërshtatshme.


18. Ndërkohë Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pranë Kryeministrisë ka kthyer përgjigje me shkresën Nr 2810 Prot datë 08.04.2020 duke e klasifikuar këtë informacion si "sekret shtetëror".

19. Me shkresën me Nr. 265 Prot datë 17.09.2020 KED ka kërkuar ndihmë administrative Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pranë Kryeministrisë për deklasifikimin e informacionit të dhënë në shkresën e saj nr. 2810 prot., datë 08.04.2020

20. Në përgjigje të kërkesës së KED, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pranë Kryeministrisë (DSIK) ka kthyer përgjigje me shkresën me Nr. 285 Prot., datë 18.09.2020 për deklasifikim të pjesshëm të informacionit, duke mbetur nga shkresa e mëparshme informacioni se, në përfundim të procedurave të verifikimit të z. [REDAKTUAR] kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, nga organet kompetente verifikuese disponohen të dhëna për kontakte të papërshtatshme.

21. Lidhur me përgjigjen e marrë nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pranë Kryeministrisë është njoftuar kandidati [REDAKTUAR] nëpërmjet e-mailit datë 21.09.2020, që të paraqitet pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe marrë dijeni mbi shkresën në mënyrë që të parashtrijë qëndrimin e tij me shkrim brenda pesë ditëve nga marrja dijeni. Kandidati [REDAKTUAR] me shkresën Nr. 270 Prot., datë 22.09.2020 ka kërkuar që të njihet dhe të marrë një kopje të akteve që ka dosja mbi verifikimin e integritetit të figurës. Kandidati u paraqit personalisht me datë 22.09.2020 dhe nga administrata e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i'u vunë në dispozicion kopjet e shkresave të kërkuara, gjithsej 24 fletë. Në vijim, kandidati [REDAKTUAR] ka paraqitur parashtrirat e tij, pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi e konkretisht:

- *Megjithëse Ligji Nr. 115/2016 dhe Vendimi Nr. 4, datë 11.03.2019 i KED, përcakton afate shumë të shkurtra për fillimin dhe përfundimin e procedurave të verifikimit të plotësimit të të gjitha kushteve ligjore të kandidimit për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, jo vetëm nuk më është bërë me dije shkresa e ardhur nga DSIK, e Protokolluar që para gati 5 muaj e gjysmë, por ende nuk kanë mbaruar procedurat në lidhje me të dhe se mjafton vetëm ky fakt, pra i mungesës së informimit të kandidatit për këtë shkresë të ardhur, dhe mosveprimi i KED për një periudhë kaq të gjatë, që tejkalon edhe periudhën e pezullimit të veprimtarisë për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, që ky proces të konsiderohet i parregullt, madje edhe i paragjykuar;*
- *Në lidhje me shkresën e datës 08.04.2020, Nr. 2810 Prot., të DSIK-së konstatoj se akti shkresor në këndvështrimin administrativ është një akt absolutisht i pavlefshëm dhe se si i tillë, sipas Nenit 116 dhe 117 të Kodit të procedurave Administrative, ky akt nuk mund të ketë fuqi detyruese, as ndaj personave apo subjekteve të cilëve iu kundrejtohet dhe as ndaj organeve të tjera të administratës shtetërore;*
- *Akti mbi të cilin është mbështetur DSIK në konkluzionin e vet është nxjerrë nga një institucion i pidentifikuar dhe se ky institucion ka kapërcyer kompetencat e saj ligjore;*
- *Ky akt është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji, pasi nga përmbajtja e Nenit 11 e vijues të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", rezulton se relacioni i DSIK duhet të përmbajë dhe institucionin që e ka krijuar si dhe elemente të tjerë që i mungojnë kësaj shkrese;*
- *Gjithashtu, sipas Nenit 10 e vijues të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", në mbledhjen e KDZH (Komisioni i Deklasifikimit, Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror", i krijuar me urdhër të ministrisë apo të institucionit) duhet të marrë pjesë*



- dhe një përfaqësues i institucionit apo organit që ka krijuar informacionin përkatës dhe se nga informacioni i dërguar nga DSIK në asnjë rresht nuk del një fakt i tillë;
- Shkresa e ardhur nga DSIK, në të cilën akuzohem padrejtësisht për kontakte të papërshtatshme, është një provë nul, e mbledhur në menyrë të paligjshme, nga një burim i paligjshëm, pasi vjen në kundërshtim me Nenin 151 pika 4 të Kodit të procedurës Penale dhe se sipas Nenit 160 pika 5, Nenit 194 pika 1 dhe 380 pika 1 të këtij Kodi këto njoftime mbi fakt as nuk duhet të merren dhe as nuk duhet të përdoren nga organet;
 - Në këtë proces është shkelur parimi kushtetues i prezumimit të pafajësisë dhe është shkelur edhe parimi kushtetues i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve;
 - Nga shkresa që më është vënë në dispozicion, e kam të pamundur të jap shpjegime ndërkohë që nuk më është bërë e ditur as institucioni që ka prodhuar informacionin, as personi me të cilin unë paskërkam "kontakte të papërshtatshme" etj;
 - Nga praktika e zbatimit të kësaj pjese të ligjit nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është mbajtur parasysh dhe është arsyetuar se në raste të ngjashme informacioni i përcjellë në këto kushte dhe rrethana nga DSIK është i papërdorshëm;
 - Në Vendimin Nr. 26, datë 21.06.2018 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka arsyetuar se informacioni i përcjellë nga DSIK-ja nuk përmban elementet e parashikuara nga Neni 38 i Ligjit Nr. 84/2016, prandaj ai konsiderohet i paplotë dhe se, duke e konsideruar procesin e rivlerësimit një proces kushtetues që, megjithëse përfshin edhe kufizimin e të drejtave të subjekteve të rivlerësimit, kërkohet ta kryejë atë gjithnjë në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, raporti për subjektin e rivlerësimit duhet të jetë konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhje këto që mund ta bëjnë edhe subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm prej tij;
 - Në Vendimin Nr. 1, datë 15.01.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është arsyetuar ndër të tjera se edhe Komisioni (KPK) në vendim, nuk ka shpjeguar se cilët kanë qenë personat e përfshirë në krimin e organizuar me të cilët subjekti ka kryer kontaktet e papërshtatshme, si dhe mbi cilat prova ka vërtetuar dyshimet e DSIK-ja se subjekti ka pasur kontakte të papërshtatshme, me të cilët ka shkëmbyer para, dhurata, favore apo pasuri, rrethana këto të cilat e kanë bindur Komisionin për të konsideruar të plotë dhe të besueshëm raportin e DSIK-së për subjektin e rivlerësimit. Më tej në këtë vendim arsyetohet se këto kushte, trupi gjykues vlerëson se rrethanat e analizuar nga Komisioni nuk plotësojnë gjithashtu as rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm i subjektit të rivlerësimit me një person të përfshirë në krimin e organizuar, të parashikuara nga Neni 38, pikat 4 dhe 5 të ligjit Nr. 84/2016. Kolegji i Apelimit në këtë vendim ka konkluduar se për pasojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit rezulton i papërshtatshëm në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk është i drejtë;
 - Në Vendimin Nr. 111, datë 06.08.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është arsyetuar se Këshilli mban parasysh faktin që nga DSIK-në kuadër të deklasifikimit të informacionit të shkresës... të dërguar pranë KED nuk është paraqitur ndonjë e dhënë konkrete apo provë kundër pastërtisë së figurës së saj në kuptim të Nenit 38/1 dhe 38/4 të Ligjit Nr. 84/2016 dhe të orientimit detyrues të dhënë në vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. 2/2017, konkretisht pikës 37 të këtij vendimi;

- Nuk ka rezultuar nga asnjë institucion i ndjekjes penale apo agjensi ligjzbatuese që të ketë të dhëna konkrete apo prova të cilat të cenojnë pastërtinë e figurës dhe integritetin e kandidatit Eugen Papandile;
 - Integriteti im provohet nga përgjigjet e institucioneve të drejtësisë në të cilat kam punuar me përkushtim dhe përgjegjësi të lartë (Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, shoqatat në mbrojtje të të drejtave të njeriut etj);
 - Integriteti im provohet nga të gjithë punonjësit, kolegët apo drejtuesit e këtyre institucioneve (disa janë pjesë e KED 2020) me të cilët kam bashkëpunuar dhe kam ndarë përgjegjësi;
 - Integriteti im provohet te përgjigja pozitive e ILDKPKI-së;
 - Integriteti im provohet te ai apartament i ndërtuar në vitin 1986, vit nga i cili vazhdoj akoma të banoj dhe ku jam bashkëpronar me 1/2;
 - Në përfundim, për arësyet e përmendura më sipër, kërkoj nga KED:
 - i) Të mos pranojë si dokument apo provë shkresën e datës 08.4.2020. me Nr. 2810 Prot., të DSIK, pasi është e paligjshme.
 - ii) Kërkoj të njihem me institucionin që e ka prodhuar këtë shkresë (nëse ka), emrin e personit me të cilin më është atribuar se kam "kontakt të papërshtatshëm", ndërveprimi im me këtë person të paidentifikuar, prova nëse unë kam shkëmbyer para, favore apo dhurata në kundërshtim me ligjin me këtë person;
 - iii) Të më vihet në dispozicion (t'i kërkohej DSIK) një procesverbal ku një përfaqësues i institucionit të origjinës ka marrë pjesë në këtë proces deklasifikimi (nëse ka marrë) në bazë të Vendimit Nr. 662, datë 15.11.2017 të KM dhe Nenit 9 pika 2 të Rregullores së DSIK;
 - iv) Të më vihen në dispozicion të gjitha aktet administrative shkresore që KED ka kërkuar nga institucionet private apo publike në lidhje me kandidatin Eugen Papandile (përveç akteve të paraqitura nga unë, apo akteve të marra nga KED me procesverbalin e datës 22.09.2020 Nr.27/1 Prot.).
 - v) Të më jepet shpjegim për sa i përket afateve të tej vonuara të njohjes time me shkresën e ardhur nga DSIK, dhe arsye se përse është mbajtur për më shumë se 5 muaj në dollapet apo raftet që mbajnë dokumentacionin në lidhje me personin tim (nëse shkak ka qenë mospajisja me certifikatën e sigurisë së relatorit, të më vihen në dispozicion kërkesat apo pengesat për pajisjen me këtë certifikatë pranë institucionit të DSIK);
 - vi) Të kërkohej asgjësimi i këtij materiali pranë DSIK, në përputhje me legjislacionin në këtë drejtim të këtij institucioni.
23. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shkresën me Nr. 274 Prot., datë 25.09.2020, ka kërkuar nga DSIK, informacion në lidhje me procedurën e ndjekur dhe një kopje të akteve shkresore në lidhje me deklasifikimin e shkresës së dërguar prej tyre në datë 08.04.2020, burimin apo institucionin që e ka prodhuar informacionin "kontakte të papërshtatshme" si dhe të dhëna të tjera të mëtejshme në lidhje me këtë informacion.
24. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pranë Kryeministrisë, me shkresën e tyre datë 29.09.2020, ka bërë me dije KED-në në lidhje me Vendimin Nr. 2069, datë 29.09.2020 të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret Shtetëror" (KDZH) në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) për të përjashtuar nga deklasifikimi praktikën në lidhje me procedurën e shkresës dërguar në KED me Nr. 2810 Prot., datë 08.04.2020.
Konkretisht:

“1) Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret Shtetëror” (KDZH) në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK me vendimin Nr. 2069, datë 29.09.2020 vendosi të përjashtojë nga deklasifikimi praktikën në lidhje me procedurën e shkresës dërguar në KED me Nr. 2810 Prot., datë 08.04.2020.”

2) Në lidhje me proceduratë deklasifikimit dhe përjashtimit nga deklasifikimi të shkresës së sipërpërmendur, DSIK ka zbatuar vendimin e Këshillit të Ministrave me Nr. 662, datë 15.11.2017 si dhe udhëzimin e drejtorit të DSIK Nr. 99, datë 13.04.2018 “Për zbatimin e Vendimit me Nr. 662, datë 15.11.2017.”

25. Në datë 01.10.2020 është njoftuar kandidati për t’u njohur me përgjigjen e DSIK datë 29.09.2020. Këtë ditë, datë 01.10.2020, kandidati [REDAKTUAR], pasi është njohur me përmbajtjen e shkresës së DSIK, nëpërmjet postës elektronike, është shprehur se nuk konstaton asnjë shpjegim apo detaj të ri krahasuar me shkresën e mëparshme të këtij institucioni dhe deklaroi se i përmbahet shpjegimeve të mëparshme të bërë nga ana e tij, me e-mail datë 24.09.2020.
26. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të Nenit 229 dhe 236 të Ligjit Nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit Nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4 datë 11.03.2019, me shkresën Nr. 36 Prot., datë 30.01.2020, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati [REDAKTUAR] për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.
27. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën Nr. 137/5 Prot., datë 17.02.2020, ka dërguar Vendimin Nr. 74, datë 13.02.2020 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin [REDAKTUAR], duke ardhur në përfundimet ndër të tjera se:
- a) Z. [REDAKTUAR]... nuk figurojnë të ketë materiale, dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, në emër të tyre, sipas Nenit 29, pika 2 të Ligjit Nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.”.
28. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c”) dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, të Nenit 237 dhe 240 të Ligjit Nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91/93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4 datë 11.03.2019, Këshilli ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidati [REDAKTUAR] në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.
29. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, pra që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, Këshilli në datën 02.07.2020 i është drejtuar me kërkesë për informacion partive politike, duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.
- 29.1 Në përgjigje të këtyre kërkesave, partitë politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidatin [REDAKTUAR]

██████████ Nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidimit, sikurse janë korrespondenca me partitë politike, konstatohet se kandidati ██████████ nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit.

30. Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 5 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "c" e pikës 1 të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, sikurse parashtrohet më sipër, si edhe nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidimit për veprimtaritë e tjera të ushtruara, konstatohet se kandidati ██████████ nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike (gjatë 10 viteve të fundit të kandidimit).
31. Gjithashtu, për këtë rast kandidimi, Këshilli vlerësoi t'i drejtohet me kërkesa për informacion disa institucioneve publike dhe subjekteve private, pranë të cilave kandidati Eugen Papandile ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të kandidatit, si Ministrisë së Drejtësisë (*shkresa Nr. 166 Prot., datë 24.07.2020*), Gjykatës së Lartë (*shkresa Nr. 167 Prot., datë 24.07.2020*), Gjykatës Kushtetuese (*shkresa Nr. 168 Prot., datë 24.07.2020*).
32. Në shkronjën "d" të pikës 1 të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati *të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi*. Nga shkresa Nr. 4669/1 Prot., datë 06.08.2020 e Ministrisë së Drejtësisë rezulton se kandidati ██████████ ka punuar si specialist në Sektorin e Legjislacionit dhe Asistencës Ligjore nga data 06.01.2004 – 15.05.2005, pranë Drejtorisë së Legjislacionit dhe Asistencës Ligjore së Ministrisë së Drejtësisë dhe se nuk ka pasur masa disiplinore të marra ndaj tij gjatë kësaj periudhe. Nga shkresa Nr. 1706/1 Prot., datë 29.07.2020 e Gjykatës së Lartë rezulton se kandidati ██████████ ka ushtruar detyrën e Ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë në periudhën 16.05.2005 deri me datë 08.04.2013 dhe se gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë masë disiplinore të marrë ndaj tij. Nga shkresa Nr. 248/1 Prot., datë 27.07.2020 e Gjykatës Kushtetuese rezulton se kandidati ██████████ ka punuar si këshilltar ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese për periudhën 02.05.2013 dhe se në këtë detyrë ai ka qëndruar deri me datë 31.12.2017. Ndërkohë nga data 01.01.2018 e në vijim ai është emëruar Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese. Në këtë shkresë rezulton se ndaj kandidatit nuk ka asnjë masë disiplinore të marrë.
33. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "b" e pikës 1 të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, pra që kandidati *"të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë"*, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati ██████████ ka përfunduar studimet e larta në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Drejtësisë në periudhën 1993 - 1997, duke u diplomuar si "*Jurist*". Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.
34. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "a" e pikës 2 të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, pra që kandidati *të ketë; të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike*, nga dokumentacioni i

shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidati [REDAKTUAR] ka parashtruar përpara Këshillit të ketë ushtruar veprimtaritë profesionale si më poshtë:

- a) Anëtar i shoqatës ELSA për periudhën 1994 - 1997;
- b) Jurist dhe gazetar në gazetën Shekulli për periudhën Janar 1998 – Qershor 1998;
- c) Jurist pranë AlbTelekom sh.a. për periudhën Qershor 1998 – Qershor 1999;
- d) Konsulent ligjor, avokat dhe koordinator projektsh pranë Grupit Shqiptar për të Drejtat e Njeriut për periudhën Qershor 1999 – Janar 2003;
- e) Konsulent ligjor dhe avokat pranë Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtat të Fëmijëve për periudhën Janar 2003 – Dhjetor 2003;
- f) Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë për periudhën Janar 2004 – Maj 2005;
- g) Anëtar bordi dhe bashkëthemelues i Institutit për Reformë Ligjore dhe Institucionale për periudhën 2005 – 2007;
- h) Anëtar bordi dhe nënkryetar i shoqatës Marshall-Center Shqipëri për vitin 2006;
- i) Lehtësues në Shkollën e Magjistraturës me datë 14 Prill 2011;
- j) Lektor i jashtëm i lëndës “E drejta penale pjesa e përgjithshme” për periudhën Tetor 2010 – 2012;
- k) Ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë për periudhën Qershor 2005 – Prill 2013;
- l) Këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese për periudhën Prill 2013 – Dhjetor 2017;
- m) Sekretar i Përgjithshëm në Gjykatën Kushtetuese për periudhën Janar 2018 e në vijim.

35. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4 datë 11.03.2019, zv/Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 05.10.2020, ora 13:00, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës nuk është përfshirë çështja me objekt shqyrtimi i gjetjeve të verifikimit për kandidimin e zotit [REDAKTUAR], për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.

36. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit Nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit Nr. 4 datë 11.03.2019, duke vlerësuar paraprakisht të përfunduar procedurën e verifikimit, anëtari i Këshillit, relator i çështjes ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit duke propozuar, në datë 02.10.2020, që, për shkak të rëndësisë aktuale që ka shqyrtimi i kandidaturave për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese, edhe ky relacion të shtohet në rendin e ditës së mbledhjes së KED-së të datës 05.10.2020, ora 13:00, në vijim të shqyrtimit të gjetjeve në procedurën e verifikimit edhe për kandidatët e tjerë të kësaj vakance. Ky propozim gjen mbështetje në paragrafin 3 dhe 4 të Nenit 16 të Rregullores së Brendshme për Funkcionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi miratuar me Vendimin me Nr. 1 datë 08.02.2019.

37. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4 datë 11.03.2019, në lidhje me këtë propozim është vënë në dijeni edhe kandidati [REDAKTUAR]

██████████, në datën 02.10.2020, i cili është shprehur se mori dijeni dhe se është dakord që kandidatura e tij të përfshihet në mbledhjen e KED-së të datës 05.10.2020.

38. Lidhur me propozimin e relatores, për përfshirjen në rendin e ditës të mbledhjes së Këshillit, të datës 05.10.2020, ora 13:00, edhe të gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatit ██████████ dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.
39. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatorja mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.
40. Në mbledhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me datë 05.10.2020, Këshilli paraprakisht miratoi përfshirjen në rendin e ditës së shqyrtimit të gjetjeve për kandidat ██████████. Gjithashtu, Këshilli gjatë shqyrtimit të gjetjeve për këtë kandidat, bazuar në nenin 50, pika c të Vendimit nr. 4 të KED-së "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", vendosi vijimin e procedurës së verifikimit të kandidaturës së Z. ██████████ lidhur me kushtin ligjor të vjetërsisë në punë. Me datë 06.10.2020 kandidati u njoftua me email për këtë fakt, duke iu kërkuar që të japë sqarime lidhur me përmbushjen e këtij kushti ligjor për veprimtaritë e ushtruara nga ai dhe të deklaruara prej tij, ndër vite.
41. Kandidati, Z. ██████████ parashitroi sqarimet me email me datë 07.10.2020 (gjithsej 4 fletë) dhe bashkëlidhi në e-mail kopje të liçencës së avokatit të vitit 2002 dhe 2003 dhe një kopje të fletës së regjistrimit themeltar Nr. 115 të Gjykatës Kushtetuese mbi të dhënat teknike të punësimit të nëpunësit. Këto shkresa u printuan bashkë me e-mailin dhe u administruan në dosje. Në shpjegimet e dorëzuara nga kandidati parashitohet se:
- Unë e plotësoj këtë kriter ligjor dhe se ky fakt provohet edhe në dokumentacionin e administruar në dosjen e kandidatit;
 - Sipas interpretimeve të bëra në Vendimin Nr. 102, datë 30.07.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke konkluduar se togfjalëshi "nëpunës i lartë në administratën publike" nënkupton evidentimin e atyre nëpunësve të administratës publike që dëshmojnë një nivel të lartë të veprimtarisë së spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës;
 - Duke pasur parasysh këtë interpretim të KED, vlerësoj se me eksperiencën time, jo vetëm që jam marrë me fusha të ndryshme të së drejtës, përfshirë të drejtën kushtetuese dhe të drejtat e njeriut, por vlerësoj se kam treguar një nivel të lartë të profesionalizmit gjatë ushtrimit të funksioneve të ndryshme;
 - Pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese, nga janari 2018 e në vijim, përbën formalisht dhe substancialisht pozicionin e juristit të lartë në administratën publike;
 - Këshilltari i Gjykatës Kushtetuese, nga maji 2013 deri në dhjetor 2017, parashikohet shprehimisht në Nenin 7/a të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese;
 - Ndihmësi ligjor në Gjykatën e Lartë, nga maji 2005 – maj 2013, parashikohet shprehimisht në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese;
 - Sipas interpretimeve të bëra në Vendimin Nr. 102, datë 30.07.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke konkluduar se togfjalëshi "nëpunës i lartë në administratën publike" nënkupton evidentimin e atyre nëpunësve të administratës

publike që dëshmojnë një nivel të lartë të veprimitarisë së spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës;
ka pasur si objekt veprimtarie hartimin e projektligjeve dhe akteve nënligjore normative, përgatitjen e mendimeve juridike mbi ligjet apo aktet nënligjore normative etj. duke konkluduar se ky pozicion duhet të përfshihet në kërkesën e Nenit 7/a të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese;

Duhet të mbahet parasysh se këtë qasje interpretative ka mbajtur edhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi;

- Për periudhën nëntor 2001 dhe Janar 2004 kam ushtruar profesionin e avokatit, sipas licencës Nr. 1389, datë 15.11.2001, të provuara nga vërtetimet e shoqatave të të drejtave të njeriut dhe librezës së punës apo pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pasi kam qenë si i vetëpunësuar;
- Nuk kam ushtruar gjatë kësaj periudhe vetëm profesionin e avokatit por kam qenë i angazhuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut;

Për rrjedhojë, duke pasur parasysh edhe tabelën e të dhënave, konkludohet se plotësoj kushtin e vjetërsisë 15 vjeçare, pasi gjithsej kam 18 vjet, 1 muaj dhe 2 ditë vjetërsi

42. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4 datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", zv. Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit, duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 09.10.2020, ora 14.00, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës, është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatinzotin [redacted] për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.
43. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4 datë 11.03.2019, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin përfundimtar të përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatit [redacted]
44. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.
45. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 09.10.2020, rendin e ditës dhe relacionin përfundimtar të përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.
46. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.
47. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli kërkoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit [redacted]

48. Avokati i Popullit parashtrroi se nuk kishte pyetje dhe komente në lidhje me procedurën e ndjekur nga Këshilli.

II. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me këtë kriter/kusht, ka vlerësuar se;

49. Këshilli i Emerimeve nr Drejtes, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nenligjore te zbatueshme per çështjen në shqyrtim si edhe në nethanat e faktit që rezultojne në aktet që permban dosja e kandidiatit vlereson se duhet te procedoje me vendim për ndalimin e kandidimit te kandidiatit [REDAKTUAR] per vendin vakant në Gjykatën Kushletuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.

50. Kushtet e kandidimit per gjyqtar ne Gjykatën Kushtetuese te parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra ne pajtim me te, duhet të plotesohen secila dhe te gjitha se bashku në menyre që kandidati te pranohet per tu vleresuar sipas meritave nga Keshilli i Emerimeve ne Drejtësi dhe me tej per tu perzgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nga organi i emertesës.

51. Per rrjedhoje, nese kandidati per gjyqtar ne Gjykatën Kushtetuese nuk ploteson qofte edhe një prej kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, kjo do të perbente motiv ligjor te mjtartueshem per Këshillin e Emerimeve ne Drejtësi për te venë ne bisedim dhe per te disponuar ndalimin e kandidimit, pa qënë e nevojshme te arsyetoje per plotesimin ose jo te kushteve te tjereligjore.

52. Nisur nga të dhënat dhe gjetjet që rezultojnë nga procedura e verifikimit për kandidatin [REDAKTUAR], Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerësoi të analizojë pikësëpari në lidhje me plotësimin ose jo të kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "a" e pikës 2 të Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike.

53. Në lidhje me këtë kusht kandidimi Këshilli shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, sikurse u përmend më lart, si dhe parashtrimin e kandidatis [REDAKTUAR], sipas të cilit ai ka ushtruar veprimtaritë profesionale si:

- a) Anëtar i shoqatës ELSA për periudhën 1994 - 1997;
- b) Jurist dhe gazetar në gazetën Shekulli për periudhën Janar 1998 – Qershor 1998;
- c) Jurist pranë AlbTelekom sh.a. për periudhën Qershor 1998 – Qershor 1999;
- d) Konsulent ligjor, avokat dhe koordinator projektsh pranë Grupit Shqiptar për të Drejtat e Njeriut për periudhën Qershor 1999 – Janar 2003;
- e) Konsulent ligjor dhe avokat pranë Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtat të Fëmijëve për periudhën Janar 2003 – Dhjetor 2003;
- f) Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë për periudhën Janar 2004 – Maj 2005;
- g) Anëtar bordi dhe bashkëthemelues i Institutit për Reformë Ligjore dhe Institucionale për periudhën 2005 – 2007;
- h) Anëtar bordi dhe nënkryetar i shoqatës Marshall-Center Shqipëri për vitin 2006;
- i) Lehtësues në Shkollën e Magjistraturës me datë 14 Prill 2011;
- j) Lektor i jashtëm i lëndës "E drejta penale pjesa e përgjithshme" për periudhën Tetor 2010 – 2012;

- REPUBLIKË E SHQIPËRI
KËSHILLI I PËRGJITHSHËM
E GJYKATËS KUSHTETUESE
- k) Ndhmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë për periudhën Qershor 2005 – Prill 2013;
 - l) Këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese për periudhën Prill 2013 – Dhjetor 2017;
 - m) Sekretar i Përgjithshëm në Gjykatën Kushtetuese për periudhën Janar 2018 e në vijim.

56. Në përgjigje të shpjegimeve të kërkuara nëse pozicionet e punës të deklaruar nga ana e tij, janë pozicione në kuptim të Nenit 7/a i Ligjit Nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, kandidati [REDAKTUAR] ka paraqitur me shkrim shpjegime dhe dokumente shtesë pranë Këshillit me email me datë 07.10.2020, me përmbajtjen e cituar në pikën 41 të këtij vendimi, (gjithsej 4 fletë) dhe bashkëlidhi në e-mail kopje të licencës së avokatit të vitit 2002 dhe 2003 dhe një kopje të fletës së regjistrimit themeltar Nr. 115 të Gjykatës Kushtetuese mbi të dhënat teknike të punësimit të nëpunësit. Gjithashtu kandidati ka dërguar me mail edhe VKM nr. 187, datë 08.03.2017. Këto dokumente u administruan në dosje dhe sikurse të gjitha aktet e tjera shpresore, iu nënshtuan shqyrtimit të Këshillit.
57. Gjithashtu në datën 09.10.2020, përpara se të fillonte mbledhja e Këshillit, prej Grupit Shqiptar të të Drejtave të Njeriut është paraqitur opinion për kandidatin z. [REDAKTUAR] Midis të tjerash, thuhet se, z. [REDAKTUAR] ka qenë një nga anëtarët më aktivë të organizatës dhe të lëvizjes së të drejtave të njeriut në fund të viteve 90 dhe në vazhdim. Në të thuhet se kandidati ka qenë pjesë e shumë trajnimeve misioneve, raportimeve, monitorimeve që organizata ka ndërmarrë nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme dhe ka dhënë kontribut të madh në çështje të vështira në shoqëri, në ndihmë të individëve që iu janë shkelur të drejtat, minoriteteve, grupeve të marginalizuara, etj.
58. Bazuar në gjetjet e sipërcituara, këshilli konkludon se, kandidati [REDAKTUAR] nuk ka ushtruar të paktën për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000.
59. Këshilli vlerëson se është detyrë e tij të analizojë natyrën juridike të veprimtarisë profesionale të ushtruar nga kandidati dhe në këtë kuptim nëse ajo përfshihet në përvojat e punës që parashikohen në dispozitat kushtetuese dhe ligjore të lartpërmendura. Për këtë qëllim, gjatë këtij vlerësimi Këshilli mban në konsideratë si qëndrimet e mëparshme të tij, ashtu edhe opinionin e Komisionit të Venecias, i cili në përfundimet e tij thekson se “është me rëndësi jetike për Shqipërinë që të ripërtërijë sa më shpejt Gjykatën Kushtetuese”.
60. Bazuar në sa më sipër, Këshilli vlerëson se funksionet e ushtruara nga gjatë karrierës së tij në periudhën 1994 – Qershor 2005 kanë të bëjnë me një përvojë pune të kandidatit që nuk përfshihet në rrethin e atyre të përcaktuara nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës apo pika 2 e Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000. Konkretisht:
- për përvojën e punës për periudhën 1994 - Nëntor 2001 edhe vetë kandidati në shpjegimet e dhëna me mail në datë 07.10.2020 nuk jep asnjë të dhënë në lidhje me faktin nëse veprimtaritë e ushtruara nga ai dhe të deklaruara prej tij hyjnë në kategorinë e atyre të parashikuara nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës apo pika 2 e Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000. Duke u nisur nga pozicioni i mbajtur nga kandidati në këtë periudhë (Anëtar i shoqatës ELSA për periudhën 1994 - 1997; Jurist dhe gazetar në gazetën Shekulli për

periudhën Janar 1998 – Qershor 1998; Jurist pranë AlbTelekom sh.a. për periudhën Qershor 1998 – Qershor 1999; Konsulent ligjor, avokat dhe koordinator projektesh pranë Grupit Shqiptar për të Drejtat e Njeriut për periudhën Qershor 1999 – nëntor 2001), Këshilli vlerëson se ajo nuk përfshihet në rrethin e atyre të përcaktuara nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës apo pika 2 e Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000

- në lidhje me periudhën **nëntor 2001 - Janar 2004** kandidati në emailin e datës 07.10.2020 shprehet se “Për periudhën nëntor 2001 dhe Janar 2004 kam ushtruar profesionin e avokatit, sipas licencës Nr. 1389, datë 15.11.2001, të provuara nga vërtetimet e shoqatave të të drejtave të njeriut dhe librezës së punës apo pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pasi kam qenë si i vetëpunësuar” duke bashkëlidhur kopje të licencës së avokatit të vitit 2002 dhe 2003. Vetë kandidati nuk sqaron nëse ka qenë i regjistruar pranë QKB për ushtrimin e këtij profesioni; ndërsa nga të dhënat e raportit përfundimtar të ILDKPI-së nuk rezulton regjistrimi i tij në organet tatimore për ushtrimin e profesionit të avokatit. Në vlerësimin e Këshillit ushtrimi i profesionit të “avokatit” në kuptim të pikës 4 të Nenit 125 të Kushtetutës apo në pikën 2 të Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000 nënkupton jo vetëm pajisjen me licencën e avokatit, por edhe ushtrimin real të këtij profesioni, sipas legjislacionit në fuqi. Për sa kohë kjo rrethanë nuk vërtetohet për kandidatin [redacted], edhe kjo periudhë nuk përfshihet në kushtin e vjetërsisë të parashikuar për kandidimin për gjyqtar kushtetues.

- Në lidhje me periudhën Janar 2004 – Maj 2005 gjatë të cilës kandidati ka mbajtur pozicionin Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, Këshilli, vlerëson se kjo eksperiencë nuk konsiderohet si eksperiencë e juristit apo nëpunësit të nivelit të lartë në administratën publike. Me Ligjin Nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, i cili ka qenë në fuqi në kohën që kandidati ka qenë duke ushtruar detyrën “Specialist” rezulton se, detyra e specialistit klasifikohet si nëpunës civil i nivelit ekzekutiv si një kategori që zbaton detyrat në përputhje me udhëzimet dhe ofron mbështetje burokratike, ose tjetër mbështetje bazë pa u përfshirë në përgjegjësi mbikëqyrëse dhe se, veprimtaria e përditshme kërkon njohuri të përgjithshme administrative dhe/ose njohuri të posaçme të një profesioni të caktuar.

- Në lidhje me shpjegimin e dhënë nga kandidati për “qasjen interpretative të mbajtur edhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi” Këshilli vlerëson se kjo qasje nuk ka të bëjë me të njëjtin pozicion pune si ai i mbajtur nga vetë kandidati (specialist në Drejtorinë e Kodifikimit pranë Ministrisë së Drejtësisë), prandaj nuk gjen vend për zbatim në këtë rast.

- Ndërsa për periudhën nga qershor 2005 e në vijim, Këshilli bazuar në vendimmarrjen e mëparshme të tij, si më sipër, vlerëson se përveç detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, edhe detyrat e ushtruara si ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Lartë dhe këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese, përfshihen në përvojat e punës në kuptim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore të lartpërmendura.

61. Si përfundim, në kuptim dhe zbatim të drejtë të dispozitave kushtetuese dhe ligjore të lartpërmendura, nisur nga të dhënat mbi kohëzgjatjen dhe llojin e veprimtarisë profesionale të ushtruar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi arrin në përfundimin se kandidati [redacted] nuk plotëson kushtin e vjetërsisë në punë për të qenë kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, duke qenë se ai ka më pak se 15 vite përvojë pune në pozicionet e kërkuara nga Neni 125 i Kushtetutës dhe Neni 7/a i ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese.

62. Këshilli vlerëson se kushtet e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, duhet të plotësohen sëçila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për tu vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për t'u përzgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nga organi i emërtesës. Në rast se kandidati nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, kjo do të përbënte motiv ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.
63. Për këto arsye, duke ardhur në përfundimin se në lidhje me kandidatin [REDAKTUAR] është i mjaftueshëm të vendoset ndalimi i kandidimit për motivin e mosplotësimit të kushtit të parashikuar nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "a" e pikës 2 të Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000, Këshilli vlerëson se nuk është vendi për të vijuar me tej me analizë dhe arsyetim mbi plotësimin ose jo të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit.
64. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidatit [REDAKTUAR] në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.

II. Pretendimet e palëve;

Pala paditëse kërkoi pranimin e padisë shfuqizimin e vendimit nr. 35, datë 09.10.2020, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke pretenduar se:

1. KED-ja nuk ka kryer një hetim të plotë në lidhje me plotësimin e kriterëve ligjore nga ana e kandidatit.
2. Së pari, ajo nuk ka marrë parasysh asnjë nga provat e paraqitura nga ana e kandidatit në lidhje me ushtrimin e profesionit të avokatit për periudhën _____. Edhe pse gjatë këtij procesi u paraqitën kopje të licensës dhe të kartës së avokatit, që provonin ushtrimin de facto të kësaj veprimtarie ato nuk u morën parasysh pa u arsyetuar në vendim arsyet për këtë qëndrim.
3. Po ashtu, para gjykatës paraqesim edhe një provë të re që është vërtetimi i Kryetarit të Dhomës së Avokatisë Tiranë, me anë të të cilit vërtetohet se "_____".
4. Sipas nenit 237 pika 2 të ligjit nr. 115/2016, për verifikimin e kriterëve ligjore, KED dërgon kërkesa me shkrim në adresë të subjekteve publike dhe private. Në rastin tim, KED nuk e ka përmbushur këtë detyrim ligjor pasi edhe pse ka marrë të gjithë kohën e mjaftueshme (shumë më shumë se 35 ditë) nuk ka bërë asnjë përpjekje për të verifikuar pretendimet e kandidatit.
5. Po ashtu, edhe pse është pretenduar nga kandidati se pozicioni i tij në Drejtorinë e Kodifikimit për shkak të natyrës dhe specifikimeve të punës, në përputhje me praktikën e vetë këtij Këshilli në raste të ngjashme, konsiderohet si jurist i nivelit të

- lartë, nuk ka bërë asnjë hetim, duke kërkuar informacion në lidhje me këtë pranë Ministrisë së Drejtësisë.
6. Nga njëra anë në vendime të ngjashme KED shprehet se përkufizimi i juristit i lartë lidhet me natyrën e punës, kurse në rastin e këtij kandidati KED ka marrë në referencë ligjin për nëpunësin civil të vitit 1999, duke iu referuar ngushtësisht niveleve drejtuese sipas këtij ligji, pa arsytuar shkaqet se për
 7. Në lidhje me këtë kriter, paraqesim si provë vërtetimin e lëshuar nga Ministria e Drejtësi në lidhje me pagën e kandidatit për periudhën _____, si dhe VKM ku sipas _____ ajo barazohet me pagën e shefit të sektorit dhe specialistit të lartë.
 8. Sipas KED-së, vetë kandidati nuk sqaron nëse ka qenë i regjistruar pranë QKB për ushtrimin e këtij profesioni; ndërsa nga të dhënat e raportit përfundimtar të ILDKPI-së nuk rezultojnë regjistrimi i tij në organet tatimore për ushtrimin e profesionit të avokatit. Në vlerësimin e Këshillit ushtrimi i profesionit të "avokatit" në kuptim të pikës 4 të Nenit 125 të Kushtetutës apo në pikën 2 të Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000 nënkupton jo vetëm pajisjen me licencën e avokatit, por edhe ushtrimin real të këtij profesioni, sipas legjisllacionit në fuqi. Për sa kohë kjo rrethanë nuk vërtetohet për kandidatin _____, edhe kjo periudhë nuk përfshihet në kushtin e vjetërsisë të parashikuar për kandidimin për gjyqtar kushtetues.
 9. Arsyetimi i Këshillit është i pabazuar në provat e administruara dhe pasojë e hetimit jo të plotë apo të mangët. Këshilli nuk ka arsytuar se përse nuk provohet ushtrimi real i këtij kur nga provat e paraqitura rezultojnë kundërta. _____
 10. Nëse në rastet e tjera KED nuk ka vënë në dyshim këtë kriter kur kandidatët edhe pse jo të regjistruar në QKB apo të pajisur me NIPT-i pasi e kanë ushtruar veprimtarinë me NIPT-in e zyrës së avokatisë ku kanë punuar, në rastin konkret KED ka kryer shkelje të rëndë procedurale që konsistojnë në mosmarrjen në konsideratë dhe mosanalizimin e provave të paraqitura duke mos arritur të arsyetojnë vendimin, si edhe në hetimin jo të plotë dhe të mangët për këtë kandidat.
 11. Para Gjykatës së Apelit, paraqitet si rrethanë e re shkresa nr.263 prot të datës 16.10.2020 Dhoma e Avokatisë Tiranë vërteton se _____ ka ushtruar profesionin e avokatit nga viti 2001 deri 2003 si anëtar i kësaj dhome dhe nuk ka detyrime financiare, masa apo procedime disiplinore ndaj tij.
 12. Qëndrimi i KED është diskriminues dhe i njëanshëm, për arsye se në vendimin tjetër për kandidatin _____, ka interpretuar Kushtetutën dhe ligjin tej kompetencave të tij, duke arsytuar se kjo lind (në mënyrë të përmbledhur) nga nevoja imediate e krijimit të Gjykatës Kushtetuese. Cfarë ka bërë KED?
 13. Neni 125 i Kushtetutës kërkon që kandidati të ketë ushtruar profesionin e gjyqtarit, prokurorit, avokatit, profesorit ose lektorit, nëpunësit të lartë të administratës publike me veprimtari të spikatur në fushën e të drejtës kushtetuese ose të drejtat e njeriut.
 14. Pra Kushtetuta kërkon që brenda këtyre profesione kandidati të ketë veprimtari të spikatur. Por në vendimin e saj _____ KED qartazi ndan këto kritere duke shkelur jo vetëm përmbajtjen e tyre por edhe në tejkalim të kompetencave të saj, pasi në rastin më të mirë duhej të kërkonte interpretimin e normës kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese, dhe konsideron se edhe pse kandidatja _____ nuk përfshihet në asnjë nga këto kategori ka veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës.
 15. Në interpretim të dispozitave ligjore, jemi përpara cënimit të procesit të rregullt ligjor pasi vendimarrja, arsyetimi i vendimit, rezultojnë ndryshe nga mendimet e dhëna me shkrim dhe nga mënyra e votimit të anëtarëve të KED, duke pasqyruar në vota dy ndalime për kriteret ndërkohë që në arsyetim të vendimit thuhet qartësisht që KED-ja ka vendosur ndalimin vetëm për kriterin e vjetërsisë 15 vjet.

16. Rregullat procedurale për verifikimin e kriterëve ligjore nga kandidatët janë përcaktuar më hollësisht në aktin normativ, Vendimi i KED nr. 4, datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë".
17. Sipas pikës 26 të këtij akti, bazuar në gjetjet e procedurës së verifikimit, nëse vlerëson paraprakisht që mund të procedohet me urdhërimin e lejimit ose të ndalimit të kandidimit, relatori njofton kandidatin e verifikuar lidhur me gjetjet paraprake, si edhe për të drejtën që të të paraqesë qëndrimin dhe shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit, si edhe të dokumentacionit mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të kandidati. Sipas pikës 30, nëse vlerëson që kandidati nuk përmbush ndonjërin prej kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, relatori procedon me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit, pa qenë i nevojshëm kryerja e procedurës së verifikimit për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore.
18. Bazuar në këto dispozita, qartësisht në mbledhjen e Këshillit, bazuar në relacionin e dërguar kandidatit dhe në shpjegimet e kërkuara kandidatit janë shtruar për diskutim 2 elemente në lidhje me kriteret ligjore, pra çështja e integritetit dhe ajo e vjetërsisë në punë.
19. Sipas pikës 40 të vendimit, nëse anëtarët e Këshillit nuk parashtrojnë pyetje dhe kërkesa të tjera sqaruese në drejtim të relatorit, Këshilli deklaron kalimin në fazën e bisedimit, votimit dhe të dhënies së vendimit, kurse sipas pikës 42, Këshilli, pasi dëgjon paraprakisht diskutimin e relatorit, bisedon dhe vendos për të gjitha çështjet që parashtrohen në relacionin e përgatitur prej tij ose që vlerësohen nga anëtarët.
20. Sa më sipër çështja e integritetit të kandidatit është bërë objekt i bisedimit dhe vendimmarrjes së Këshillit. Kjo përforcohet edhe nga qëndrimi në pakicë i dy anëtarëve të Këshillit (edhe pse i quajtur paralel), ku shprehen se Këshilli duhej të vendoset ndalimin për kriterin e figurës, çka a contrario interpretohet se ky kriter është kaluar dhe ezauruar prej KED, edhe pse kjo, në kundërshtim me kërkesat e një akti administrativ të arsyetuar duhej të gjente shprehje në vendim.
21. Sipas neneve 43-45 të vendimit nr. 4, nuk njihet mendimi paralel por vetëm ai kundër i anëtarëve. Pasi për sa kohë një çështje kalon në votim ka vetëm vota pro ose kundër.
22. Edhe pse në vendim nuk ka një arsyetim të Këshillit në lidhje me këtë kriter, nga qëndrimi i anëtarëve me mendim paralel të bën të konkludosh të kundërtën, pra se ky kriter është diskutuar dhe votuar. Për sa kohë që nuk kam në dispozicion procesverbalet e diskutimeve, por duke u nisur vetëm nga përmbajtja e vendimit dhe baza ligjore e zbatueshme, qartësisht konkludohet se ka një mospërputhje mes pjesës arsyetuese dhe dispozitivit të vendimit, cka e bën vendimit të paqartë dhe alogjik.
23. Edhe pse gjyqtaret paralel kanë një qëndrim të ndryshëm në lidhje me këshillin për shkakun e ndalimit, ato duhej të ishin shprehur vetëm në këtë drejtim, pra të arsyetonin se këshilli duhej të analizonte dhe shprehej edhe për kriteret e tjera. Por për sa kohë ato i kanë hyrë vlerësimit të këtij kriteri në mendimin paralel, automatikisht kjo të con në qëndrimin se këshilli e ka analizuar dhe votuar e vlerësuar atë.
24. Në përputhje me nenin 237 të ligjit nr. 115/2016, kriteret ligjore të kandidatit shqyrtohen në një procedurë të ndryshme nga ajo e pasurisë dhe integritetit, cka nënkupton se në rast të mosplotësisë të këtij kriteri, kandidati ndalohet pa vijuar me kriteret e tjera. Jo më kot kjo dispozitë ka parashikuar edhe një afat 35 ditor për Këshillin pasi këto kriteret nuk kanë nevojë për analizë dhe hetim të thelluar. Në

- përfundim të analizës së cdo kriteri Këshilli, ashtu si edhe formalisht dhe vizualisht i ndan edhe në vendimet e veta, shprehet për ndalimin ose lejimin e kandidimit, pra pasi ia nështron vlerësimin dhe votimit secilin kriter nëse është rasti. Por në rastin tim, nga mënyra se si arsyetohet në mendimin paralel, Këshilli duket se e ka analizuar kriterin e integritetit dhe ka vendosur lejimin e kandidimit për atë kriter.
25. Në këtë kuptim duke konsideruar dy votat në KED kundër kandidimit, i kërkoj kësaj Gjykate ezaurimin e këtij kriteri pasi në llogjikën sa më lartë duhet marrë si Lejim në lidhje me kriterin e integritetit. (bashkelidhur padisë do të gjeni dhe shpjegimet e plota ku kërkoj që ai akt administrative të bëhet nul si absolutisht i pavlefshëm)
 26. Zvarritjet dhe vonesat në procedurën e punës së KED, kanë sjellë shkeljen e parimit të proporcionalitetit
 27. Kufizimet e vëna ndaj mosnjohjes së profesionit të avokatit apo juristit të spikatur të drejtave të njeriut apo mosnjohjes së punës profesionale të juristit të Drejtorisë së Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, siç janë analizuar në fillim, duke passjellë ndalimin e kandidimit nuk janë proporcionale.
 28. KED-ja jo vetëm ka shkelur Parimi i proporcionalitetit, i cili në vetvete përmban besueshmërinë dhe parashikueshmërinë-intuitën e administratës publike, duke kuptuar thelbësisht se veprimet administrative duhet të jenë proporcionale me qëllimin që duhet të arrihet në pajtim me ligjin. Parimi i proporcionalitetit është i lidhur me "arsyeshmërinë" (afat i arsyeshëm, mënyrë e arsyeshme), veçanërisht është i zhvilluar dhe i përmbajtur nga Gjykata Europiane e drejtësisë.
 29. Pyetja e tretë është, a janë proporcionale dhe jo diskriminuese trajtimet e pabarabarta që ka bërë KED-ja duke mos më njohur vjetërsinë sipas provave të sjella prej meje për periudhë që kam punuar si jurist dhe avokat në shoqërinë civile në mbrojtje të të Drejtave të Njeriut ashtu si dhe duke mos më trajtuar në mënyrë të barabartë si kandidatët e tjerë për sa I përket njohjes së vjetërsisë në punë në periudhën kur kam qenë specialist në Drejtorinë e Kodifikimit (nuk ka nivel më të lartë në gjithë administratën se sa të jesh pjesë e kësaj Drejtorie që sipas Legjislacionit rregullon "gabimet" e gjithë pjesës tjetër të Administratës juridike dhe jo vetëm)
 30. Gjithashtu kërkoj nga kjo Gjykatë që për shkak të shkeljeve të rënda procedurale brenda procesit të rregullt ligjor siç garantohet me nenin 6 § 1 të Konventës, ky proces duhet të interpretohet jo strikt dhe në dritën e sundimit të ligjit, i cili kërkon që të gjithë palët ndërgjyqëse të kenë një mjet efektiv gjyqësor që u mundëson atyre të pohojnë të drejtat civile (shih Bëlesh dhe të tjerë kundër Republikës Çeke, nr 47273/99, § 49, GJEDNJ 2002-IX). Çdokush ka të drejtë të ketë ndonjë kërkesë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile të sjella para një gjykate. Në këtë mënyrë, neni 6 § 1 229 mishëron "të drejtën për një gjykatë", për të cilën e drejta e qasjes, dmth.e drejta për të filluar procedime para gjykatave në çështjet civile përbën vetëm një aspekt (shih Cudak kundër Lituanië [GC 15869/02, § 54, GJEDNJ 2010, Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar, 21 shkurt 1975, § 36. Seria A nr 18, dhe Princi Hans-Adam II i Lihtenshtajn kundër Gjermanisë [GC], nr. 42527/98, § 43, GJEDNJ 2001-VIII).

Pala e paditur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kërkoj rrëzimin e padisë duke prapësuar se:

1. Referuar pretendimeve në tërësi të palës paditëse, rezulton qartësisht e provuar se jo vetëm që nuk kemi të bëjmë me shkelje të rënda procedurale në lidhje me procedurën që ka ndjekur KED në lidhje me shqyrtimin e vlerësimin paraprak të kandidaturës së paditësit, por në disa drejtime ato janë çështje të cilat kanë të bëjnë me themelin e

- çështjes, pra me elementë të cilët janë totalisht në diskrecion të Këshilli Emërimeve në Drejtësi.
2. Mbi bazën e përcaktimeve të ligjit nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", është miratuar edhe akti normativ, vendimi nr. 4, datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", në të cilin janë parashikuar një sërë të drejtash dhe garancish për kandidatët në kuadër të transparencës dhe përzgjedhjes së kandidatëve më të mirë të mundshëm për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.
 3. Në asnjë moment, qoftë relatori i çështjes apo anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nuk kanë vepruar në kundërshtim me ligjin, apo të kenë qenë të njëanshëm, gjë e cila të ketë ndikuar në cënimin e të drejtës së palës paditëse. Gjithashtu, çdo veprim që kanë kryer anëtarët e KED kanë qenë në përputhje të plotë me qëllimin që u ka vendosur ligji. 62. Nga pala paditëse kërkohet pavlefshmëria e vendimit nr. 35, datë 09.10.2020 "Për ndalimin e kandidimit të kandidatit [REDAKTUAR], në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019", por në asnjë moment nuk arsyetohet se në cilat drejtime kërkohet kjo pavlefshmëri. Në asnjë pretendim të ngritur nga pala paditëse nuk është pretenduar se vendimi objekt i këtij gjykimi, nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve të parashikuara në nenin 108 të K.Pr.Administrative, që jep nocionin rreth aktit administrativ absolutisht të pavlefshëm, i cili konsiston në: a) akti vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj".
 4. Në lidhje me pretendimin për ta deklaruar të pavlefshëm vendimin objekt shqyrtimi, nuk rezulton që Këshilli të ketë shkelur rregullat dhe procedurat që parashikon K.Pr.Administrative, Ligji nr. 115/2016, si dhe Vendimi nr. 4/2019 i KED që ka lidhje me kryerjen e një hetimi të plotë, të gjithanshëm e të rregullt ligjor. Nuk rezulton që nga pala paditëse të jetë pretenduar se KED nuk ka kryer rregullisht njoftimin e tij në lidhje me veprimet që ka kryer, si dhe me të dhënat që ka mbledhur pranë institucioneve të treta për këtë kandidat. Në asnjë paragraf të padsë, nuk rezulton që paditësi të ketë pretenduar se i është mohuar e drejta për tu mbrojtur dhe për të dhënë shpjegimet dhe qëndrimet e tij në lidhje me gjetjet e Këshillit gjatë hetimit administrativ. Nuk rezulton që paditësi të ketë pretenduar se i është mohuar e drejta për tu dëgjuar, si dhe këshilli të mos ketë respektuar parimin e kontradiktoritetit në shqyrtimin e rastit të tij. Rezulton qartësisht e provuar se të gjitha shpjegimet e dhëna nga paditësi në lidhje me hetimin administrativ si dhe me gjetjet e këtij hetimi administrativ, janë reflektuar qartësisht dhe korrektësisht në të gjitha aktet që ka marrë në shqyrtim këshilli si dhe ka debatuar për të arritur në vendimin përfundimtar.
 5. Në të kundërt, të gjitha detyrimet që imponon ligji i zbatueshëm si dhe aktet nënligjore mbi bazën e të cilit rregullohet veprimtaria hetimore administrative e këshillit, rezultojnë të jenë zbatuar në mënyrë korrekte dhe ti kenë garantuar qartësisht paditësit kryerjen e një procesi të rregullt ligjor në shqyrtimin e rastit të tij. Për të dhënë një përgjigje shteruese paditësit në lidhje me pretendimin e tij për pavlefshmërinë e vendimit objekt shqyrtimi, i kërkohet gjykatës që të mbajë në vëmendje edhe këto fakte të cilat konsistojnë në: Nuk rezulton që i) këshilli të mos

- jetë organi kompetent i cili ka nxjerrë vendimin objekt shqyrtimi qëakti të mos përmbajë elementët thelbësor dhe ato formalë që janë të detyrueshëm për të qenë i vlefshëm, iii) që vendimi të jetë marrë nën formën e mashtrimit, kanosje, mitmarjes, konfliktit të interesit etj; Gjithashtu, nuk rezulton që në çështjen objekt shqyrtimi paditësi të ketë identifikuar normat konkrete juridike të së drejtës pozitive që janë shkelur nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Kjo merr më shumë rëndësi në kushtet kur kjo mosmarrëveshje dhe ky gjykim ka për objekt vetëm çështje të së drejtës procedurale të respektuar ose jo nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
6. Të pretendosh një shkelje apo një mënyrë të ndryshme të interpretimit të ligjit nuk do të thotë apriori (apo edhe nëpërmjet interpretimeve të ndryshme), se kemi të bëjmë me shkelje procedurale dhe për më tepër shkelje të rënda procedurale. Gjatë gjithë parashtrimeve në padi, pala paditëse është fokusuar tek fakti se është diskriminuar apo trajtuar në mënyrë të pabarabartë, kohë në të cilën këto çështje, nuk kanë të bëjnë me aspektin e shkeljeve procedurale gjatë shqyrtimit të çështjes, por me aspektin material të trajtimit të saj. Pra, nëse Këshilli ka interpretuar ligjin në disa raste jo në mënyrë uniforme, kjo nuk përbën shkak që vendimmarrja e saj të konsiderohet e pavlefshme mbi bazën e kërimit të paditësit, pasi në çdo rast për tu vërtetuar ky fakt, gjykata do të duhej që ti hynte shqyrtimit në themel të këtyre çështjeve.
 7. Referuar nenit 238 të ligjit nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", rezulton tërësisht e qartë që ndaj vendimeve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, mund të bëhet padi vetëm për shkelje të rënda procedurale. Në këtë kuptim, shkelja e pretenduar se është kryer nga organi publik, duhet të jetë në atë shkallë sa i gjithë procesi të mund të zhbëhet dhe të kthehet në pikën fillestare. Në rast se paditësi ka pretenduar se ka standarte të dyfishta nga ana e KED duke ju referuar qëndrimin që ky organ ka mbajtur në çështjen e paditësit dhe në atë të mbajtur në raste të tjera, ky pretendim nuk ka të bëjë me procedurën e shqyrtimit të çështjes, por ka të bëjë me zgjidhjen në themel të saj. Në asnjë rast, pala paditëse nuk ka evidentuar, nuk ka pretenduar dhe as nuk rezulton të jetë e provuar se procedura e ndjekur në shqyrtimin e çështjes së tij, është bërë në mënyrë të ndryshme nga procedura që është ndjekur për kandidatë të tjerë. Në këtë drejtim, pretendimi se kemi interpretim të ndryshëm të ligjit në raste të njëjta përsa i përket lejimit apo ndalimit të kandidatëve, nuk kanë të bëjnë me shkelje të rënda të procedurës së vlerësimit, por me zgjidhjen në themel të çështjes.
 8. Pavarësisht faktit se në objektin e padisë, pala paditëse ka pretenduar pavlefshmërinë e vendimit objekt shqyrtimi (pra nulitetin e tij), gjatë arsytimit të parashtrimeve të tij në padi, ai ka pretenduar edhe paligjshmërinë e aktit. Në këtë drejtim, për ti dhënë një përgjigje shteruese paditësit në lidhje me pretendimin e tij, vlerësojmë se duhet ti referohemi edhe nenit 109 të K.Pr.Administrative, në të cilin parashikohet se: ""Një akt administrativ është i paligshëm nëse: a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës; b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi; d) është në kundërshtim me ligjin material; dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit "".
 9. Nga interpretimi literal i dispozitës së sipërcituar, rezulton seqë të kërkosh shfuqizimin e aktit administrativ, duhet të plotësohet të paktën njëri nga elementët eparashikuar nga nenin 109 i K.Pr.Administrative për ta bërë aktin të paligjshëm dhe që paditësi ti cënohen interesat e ligjshme të pretenduara. Kështu, rezulton qartësisht e provuar se vendimi objekt kundërshtimi është nxjerrë nga organi publik që e ka në

kompetencë për ta nxjerrë atë. Gjithashtu, ky vendim është nxjerrë në përputhje të plotë me rregullat dhe procedurën administrative që rregullon këtë mosmarrëveshje. Padiësi nuk rezulton në asnjë paragraf të pretendimeve të dhëna prej tij, se cila është shkelja konkrete në procedurën e ndjekur nga Këshilli për shqyrtimin e kandidaturës së tij. Mosrespektimi i afateve nuk përbën shkelje të rëndë të procedurës, përse kohë palës padiëse nuk i është cënuar apo mohuar ushtrimi i ndonjë të drejte themelore dhe substanciale që do ta bënte procedurën të pavlefshme. Pala padiëse nuk rezulton të ketë pretendime në lidhje me të drejtën për tu dëgjuar, të drejtën për tu mbrojtur, të drejtën për të pasur kontradiktoritet mendimesh dhe opinionesh, të drejtën për tu informuar dhe për të dhënë shpjegime. Për këtë arsye, pala nuk rezulton të ketë asnjë pretendim në lidhje me shkelje të rënda të procedurës administrative të ndjekur për shqyrtimin e kësaj çështje;

10. Vendimi objekt kundërshtimi nuk rezulton të jetë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementët e detyrueshme të aktit administrativ. Për këtë moment, pala padiëse është e qartë dhe nuk ka asnjë kundërshtim përse i përket elementëve të aktit administrativ. Nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi janë respektuar në mënyrë rigoroze kërkesat e neneve 98, 99 dhe 100 të K.Pr.Administrative. Ky vendim nuk rezulton të jetë nxjerrë në mungesë të autorizimit nga ligji. Kushtetuta dhe ligji 115/2016 kanë ngarkuar dhe autorizuar KED për të bërë verifikimin dhe vlerësimin e kandidatëve, duke respektuar kërkesat e pikës 2 të nenit 4 të K.Pr.Administrative. Vendimi objekt kundërshtimi nuk është në kundërshtim me ligjin material. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka respektuar në mënyrë rigoroze kushtet dhe kriteret që ka përcaktuar ligji dhe që duhen plotësuar nga ana e padiësit, me pasojë për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit.
11. Gjithashtu, në vendimin objekt kundërshtimi nuk rezulton që KED të ketë ushtruar diskrecionin në mënyrë të paligjshme. Çdo veprim i kryer dhe çdo vendim i marrë nga KED nuk është ushtruar tej asaj që ka parashikuar pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës, shkronja "a" e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 217 dhe vijues të ligjit nr. /2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë". Vendimi objekt kundërshtimi është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, si dhe është marrë në përputhje me gjendjen që e ka diktuar atë. Akti administrativ objekt gjykim është pasojë e mosplotësimin të kushteve dhe kriterëve të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës, shkronja "a" e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe si pasojë e të cilit ka dalë vendimi nr. 35, datë 09.10.2020.
12. Në lidhje me pretendimin e palës padiëse në lidhje me kurumin e marrjes së vendimit objekt shqyrtimi, prapësojmë se ai është marrë në përputhje të plotë me parashikimet ligjore. Vendimi për ndalimin e padiësit për të vijuar garën është marrë në mënyrë unanime nga ana e këshillit, duke pasur si argument të vetëm mosplotësimin e kriterëve që kërkon ligji për vijuar këtë garë. Referuar përcaktimeve të Kushtetutës dhe ligjit nr. 115/2016 ligjvënësi ka përcaktuar tre kriterë kryesore për tu plotësuar nga kandidati në mënyrë që ai të konsiderohet i kualifikuar në vlerësim paraprak, të cilat janë a) kriteri i pasurisë; b) kriteri i pastërtisë së figurës; dhe c) kriteri i vjetërsisë në detyrë dhe ushtrimin të veprimtarisë profesionale. Të tre këto kriterë që ka parashikuar ligji janë të natyrës kumulative, ç'ka nënkupton faktin se mosplotësimi goftë edhe vetëm i njërit prej tyre, e ndalon automatikisht kandidatin për të vijuar garën. Në këtë drejtim, nuk ka asnjë paqartësi në lidhje me kuorumin dhe vendimmarrjen që ka marrë këshilli për padiësin.
13. Vendimi nr. 35, datë 09.10.2020 për ndalimin e kandidimit të padiësit për tu zgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese për pozicionin vakant të shpalluar nga Presidenti i

Republikës, është marrë qartësisht në unanimitet të plotë nga të gjithë anëtarët, por shprehja e opinionit të tyre është vlerësuar të bëhet në mënyrë të ndryshme. Në këtë vendim nuk kemi mendim kundër të pakicës, por kemi mendim paralel të tyre. Ndalimi i kandidimit të palës paditëse është bërë për shkak se ai nuk plotëson njërën nga kriteret kumulative që ka parashikuar ligji dhe për këtë arsye, shumica e anëtarëve në vendimin objekt shqyrtimi ka qartësuar në pikën 53, 62 dhe 63 të këtij vendimi, se nuk është e nevojshme që në raste të tilla, Këshilli të marrë në analizë të gjithë kriteret, pasi në përfundim rezultati për ndalimin nuk mund të ndryshojë. Ndërsa në mendimin paralel, dy anëtarët e tjera të Këshillit kanë pohuar se kanë votuar për ndalimin e kandidimit të paditësit (referojuni paragrafit të dytë të mendimit paralel), duke argumentuar se ky ndalim duhet të bëhet për shkak të kriterit që ka lidhje me integritetin e kandidatit (ndryshe nga sa pretendon paditësi në faqen 21, paragrafi i tretë i padisë).

14. Fakti që vendimi objekt kundërshtimi ka mendim paralel, nuk e bën procedurën e ndjekur nga Këshilli në votimin për kandidaturën e paditësit të pavlefshëm, sikundër pretendon ai në padi. Paditësi me pretendimet e ngritura ka krijuar konfuzion në lidhje me qëndrimin që ka mbajtur shumica e anëtarëve të Këshillit për sa i përket kriterit të integritetit të figurës, duke arritur në konkluzinin se, kjo shumicë ka vlerësuar që paditësi e plotëson kriterin e pastërtisë së figurës, por nuk plotëson kriterin e vjetërsisë në punë dhe ushtrimit të veprimtarisë profesionale. Vlen të theksohet fakti se, Këshilli në vendimin e tij ka pasqyruar të gjitha të dhënat e siguruara në drejtim të të tre kriterëve ligjore. Megjithatë kjo nuk do të thotë që këshilli ka pasur detyrimin për tu shprehur në lidhje me të gjitha këto kriterë.
15. Shumica e anëtarëve të KED nuk e kanë parë fare të arsyeshme për tu ndalur dhe analizuar kriterin që ka lidhje me pastërtinë e figurës dhe integritetin e kandidatit, përse kohë kanë vlerësuar se ai nuk plotëson kriterin e vjetërsisë në punë, sikundër nga ana tjetër dy anëtarët në mendimin paralel nuk kanë vlerësuar të arsyeshme që të analizojnë kriterin e vjetërsisë dhe ushtrimit të profesionit, pasi kanë vlerësuar të analizojnë vetëm kriterin e pastërtisë së figurës dhe integritetit të kandidatit. Për më tepër, që as shumica e anëtarëve të këshillit dhe as dy anëtarët që kanë shprehur mendim paralel nuk janë ndalur fare dhe nuk kanë dhënë asnjë konkluzion në lidhje me kriterin e pasurisë, të cilin paditësi nuk rezulton ta ketë pretenduar nëse Këshilli e ka vlerësuar apo jo. Në këtë drejtim, vendimmarrja e këshillit në thelb ka qenë për ndalimin e kandidimit të paditësit, pasi nuk plotësohen të paktën një nga kriteret kumulative që parashikon ligji. Mendimi paralel i dy anëtarëve lidhur me kriterin për të cilin duhet ndalur kandidimi i paditësit, nuk e bën të pavlefshëm vendimin në tërësi të tij.
16. Përkundrazi ky arsyetim në mendimin paralel ka si qëllim dhe është në funksion të respektimit të parimit të transparencës së këshillit gjatë vendimmarrjes së tij.
17. Edhe pretendimi i paditësit se vendimi objekt shqyrtimi është i paarsyetuar apo kaotik nuk qëndron, pasi si mendimi i shumicës së anëtarëve ashtu edhe ai i dy anëtarëve me mendim paralel kanë dhënë qartësisht argumenta për vendimin e ndalimit të kandidimit të paditësit, duke përmbushur në këtë drejtim standartin kushtetues që duhet plotësuar në procesin e arsyetimit të vendimit. Po ti referohemi vendimit objekt gjykimi nga pika 53 e tij dhe deri në pikën 61 është arsyetuar dhe sqaruar në mënyrë shteruese vendimmarrja e këshillit për ndalimin e kandidimit të palës paditëse. Kjo pjesë e argumentimit të vendimit në pikat e sipërcituara, i japin përgjigje edhe pretendimeve që ka ngritur pala paditëse në këtë padi, duke arsyetuar qartë faktet, rrethanat dhe provat. Nuk mund të pretendohet se kemi shkelje të rënda procedurale për mosarsyetim vendimi, vetëm me argumentin se ky arsyetim ezaurues i Këshillit të

- Emërimeve në Drejtësi është i kundërt me interesat apo pritshmëritë e palës paditëse. E ritheksojmë edhe njëherë se është diskrecion i Këshillit interpretimi i fakteve, rrethanave, pretendimeve dhe provave, si dhe vlerën që ajo u jep atyre në raport me njëra tjetrën. Kjo është sqaruar më së miri në vendimin objekt gjykimi në pikën 38 - 61 të tij, duke sqaruar në mënyrë shteruese këto pretendime.
18. Në lidhje me pretendimin e palës paditëse, e cila ka natyrë procedurale dhe që lidhet me mosrespekimin e afateve nga ana e Këshillit, prapësojmë se këto afate nuk janë me natyrë prekluzive. Është mëse e arsyeshme që ligji parashikon vendosjen e afateve me qëllim që një procedurë apo e drejtë të ushtrohet dhe të realizohet brenda një kohe të arsyeshme. Megjithatë, ligji e përcakton qartësisht kur këto afate kanë karakter prekluziv, pra mosrespektimi i tyre të shuajë të drejtën e subjektit (organit) për të ushtruar një të drejtë të caktuar dhe të parashikuar me ligj. Në këtë kuptim afatet procedurale të përcaktuara për kryerjen e veprimtarisë hetimore administrative nga ana e Këshillit nuk janë kufizuese (prekluzive), ç'ka nënkupton se me kalimin e tyre Këshilli të mos mundet më të veprojë apo të japë një vendim përfundimtar. Gjithashtu, shkëlja e afateve të shqyrtimit nuk rezulton që të kenë ndikuar në cënimin e paditësit për të pasur një proces të rregullt ligjor, duke ju shkelur të drejta themelore të cilat ta bëjnë procesin e shqyrtimit administrativ absolutisht të pavlefshëm. Paditësi ka vijuar të jetë në garë për të njëjtën periudhë kohe me të gjithë kandidatët e tjerë që kishin garuar për të njëjtin pozicion vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, duke ju mundur madje që kërkesa e tij të kalonte për vlerësim e shqyrtim nga Këshilli në të njëjtën datë me të gjithë kandidatët e tjerë (referojuni paragrafit 42 të vendimit objekt shqyrtimi).
19. Nuk rezulton që Këshilli të mos i ketë njoftuar paditësit aktet e marra gjatë shqyrtimit hetimor administrativ, nuk rezulton që paditësit të mos i jetë dhënë një afat i arsyeshëm për të paraqitur pretendimet apo prapësimet e tij; nuk rezulton që pala paditëse të ketë kërkuar afate me të gjata kohore për të dhënë shpjegimet e tij, për të mbledhur prova dhe për të paraqitur ato përpara se Këshilli të marrë një vendim përfundimtar në lidhje me kërkesat e tij. Gjithashtu nuk ka asnjë pretendim apo fakt dhe rrethanë të arsyeshme që të evidentojë faktin se Këshilli ka shkelur afatet e shqyrtimit me qëllim paragjykimin e çështjes apo diskriminimin e paditësit. Për këtë arsye, edhe nëse procesi hetimor për vlerësimin e kandidaturës së paditësit ka zgjatur për gati 1 vit, kjo nuk e ka cënuar të drejtën e tij për të pasur një proces të rregullt ligjor, përsa kohë Këshilli ka vlerësuar që përpara se të marrë në vendim përfundimtar të kryente një veprimtarë hetimore në mënyrë të plotë, të thelluar dhe të gjithanshme, duke siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm për të tre kriteret ligjore që kërkon kandidimi për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.
20. Në vijim të të gjitha pretendimeve të ngritura nga pala paditëse, e shohim të arsyeshme që të evidentojmë faktin se, edhe institucioni i Avokatit të Popullit, i cili ka marrë pjesë dhe e ka ndjekur hap pas hapi të gjithë procedurën hetimore administrative të për vlerësimin e paditësit si kandidat për pozicionin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, nuk ka shprehur asnjë rezervë dhe asnjë koment në lidhje me këtë procedurë të ndjekur. Ky qëndrim i këtij institucioni, i cili luan edhe rolin e garantuesit të të drejtave të kandidatëve për të pasur një proces të rregullt ligjor, respektimit të parimit të ligjishmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së procesit të për zgjedhjes së kandidatëve nga Këshilli për publikun, pasqyrohet qartësisht në pikën 47 dhe 48 të vendimit objekt shqyrtimi.
21. Duke ju referuar edhe njëherë nenit 238 të ligjit nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", ku parashikohet se paditë kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit bëhen në Gjykatën

Administrative të Apelit vetëm për pretendime që kanë të bëjnë me shkelje të rënda procedurale, atëherë arrijmë në përfundimin dhe prapësimin thelbësor se ky Këshill. palë e paditur në këtë gjykim, nuk ka kryer shkelje procedurale, aq më tepër "të rënda" sikurse e kërkon ligji, të cilat i kanë cenuar interesat e ligjshme të palës paditëse. Përkundrazi, pretendojmë se në procedurën e verifikimit të kandidaturës së paditësit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vepruar rigorozisht në përputhje me pikën 4 të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "a" të pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenet 217 dhe vijues të ligjit nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", si edhe në përputhje me K.Pr.Administrative.

22. Për të gjitha arsyet e parashtruara si më sipër, bazuar në faktet dhe rrethanat të cilat janë pranuar si në vendimin nr. 35, datë 09.10.2020 të KED ashtu edhe në këtë gjykim, si dhe praktikës konstante që kjo gjykatë ka mbajtur në mënyrë vijuese në lidhje me këto lloj kërkesesh, kërkojmë: **Rrëzimin e padisë së paraqitur nga paditësi Eugen Papandile, si të pambështetur në prova dhe në ligj.**

Personi i tretë Presidenti i Republikës, nuk paraqiti parashtrime me shkrim, por në seancë gjyqësore, dhe këto shpjegime:

- Sa i takon dhe pyetjes së parë që parashtrova për palën e paditur, ka një tejkalim të afatit ligjor të shqyrtimit të kandidaturave për këtë vakancë me disa muaj. Afati maksimal 3 muaj, KED po mbush muajin e 11 dhe shakqet e vonesave që përfaqësuesit e KED nuk kanë dijeni, KED i ka bërë vetë publike, i ka të zbardhura në procesverbale dhe në informacionin për publikun që KED ka bërë pse kanë ardhur vonesat. Një nga vonesat është dhe mospajisja jo vetëm e relatores, por e një pjese të anëtarëve të KED me certifikatat e sigurisë që lëshon DSIK. Pra, hetimi administrativ për figurën ka nisur nga një relatore që s'kishte certifikatë sigurie për vete. Dhe kjo është një shkelje që është pranuar nga vetë KED, nuk po e them unë për herë të parë. Këto përbëjnë dy shkelje të rënda. Nëse KED do të kishte marrë dhe do ta kishte vlerësuar me seriozitet opinionin e Komisionit të Venecias, do të kuptonte ç'do të thotë nevojë jetike për Gjykatën Kushtetuese. Është shkelje e rëndë procedurale? Këtu kemi të bëjmë më nevojë jetike, nuk ka më shkelje, sepse në momentin që kanë shqyrtuar kandidatët [redacted] dhe [redacted] në garë, për këtë vakancë, kishte një të kualifikuar dhe dy të tjerë që prisnin të kandidonin, të tjerët ishin skualifikuar. Pra risikohej dhe numri që kërkon Kushtetuta etj.
- Sa i takon 15 vjet përvojë pune, Kushtetuta nuk e ndan nëse është kusht apo kriter, e ndan ligji. Neni 7/a,1 dhe 2 e thotë shumë qartë. Pra është kriter, është në nivel pak më të ulët se kushti që është i domosdoshëm. Sepse kriteri është dhe objekt vlerësimi me pikë nga KED më pas. Prandaj është më i lehtësueshëm, ose KED nuk duhet të ishte kaq strikt në arsyetimin e rrethanave.
- Në lidhje me këtë, KED duhet të kishte hetuar më shumë dhe kohën e ka pasur të mjaftueshme t'i kërkonte dhe kandidatit, ashtu siç solli sot vendimin e gjykatës, mund të kishte sjellë gjithë relacionet, mbrojtjet ligjore që kandidati ka punuar tek ajo qendër apo tek ajo shoqate ku ka pasur marrëdhëniet e punës së tij. Nuk ka lidhje me pagimin e taksave, se ky avokatinë e ka ushtruar brenda asaj qendre, por e ka ushtruar përmes një OJF, avokati të palëve por në funksionin e juristit apo avokatit. Është e spikatur apo jo, duhet të ishte hetuar më shumë.

Personi i tretë Komisioneri për Diskriminimin, parashtroi se:

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vijim referohet si Komisioneri), është një institucion që ushtron veprimtarinë në bazë të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2012 "Për mbrojtjen nga Në bazë të nenit 21, të këtij ligji, Komisioneri siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin".
2. Paraprakisht bëjmë me dije se paditësi nuk ka paraqitur një ankim për diskriminim pranë institucionit tonë. Kjo do të thotë që Komisioneri nuk ka shqyrtuar çështjen administrativisht, nuk ka kryer veprime procedurale për hetimin administrativ, nuk ka arritur në një konkluzion të materializuar me vendimarrje përkatëse.
3. Në ligjin 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" parashikohet e drejta për t'u ankuar në rrugë gjyqësore, çdo personi ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim. Kjo e drejtë nuk kushtëzohet nga detyrimi për të ezauruar më parë ankimin përpara Komisionerit (34, pika 2)1 dhe as detyrimin e të dëmtuarit të njoftojë Komisionerin para se të paraqesë një padi për diskriminim në gjykatë (neni 36, pika 2)
4. Ky mendim me shkrim i Komisionerit hartohet mbi njohuritë specifike të fushës së anti-diskriminimit dhe bazohet në aktet e vëna në dispozicion nga ana e gjykatës, vetëm një ditë para zhvillimit të seancës gjyqësore, nga ku rezulton se: Presidenti i Republikës, në datën 22.11.2019, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të Gjyqtarit [REDAKTUAR]
5. Paditësi Eugen Papandile, si një ndër kandidatët, ka shprehur interesin për vendin vakant dhe në datë 23.01.2020 ka depozituar pranë sekretarisë së KED formularët e deklaramentit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij.
6. KED në përfundim të procesit të verifikimit, bazuar në gjetjet e raportuara në vendimin objekt gjykimi, ka konkluduar se kandidati [REDAKTUAR], nuk ka ushtruar të paktën për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "a" e pikës 2 të Nenit 7/a të ligjit 8577/2000.
7. Për këtë arsye, KED ka vendosur ndalimin e kandidimit të z. [REDAKTUAR] në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.
8. Në nenin 34, pika 2 të Ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi" parashikohet shprehimisht se "Paragjitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është: kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t'i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale".
9. Në nenin 36, pika 2 të Ligjit "Nr mbrojtjen nga diskriminimi" parashikohet shprehimisht se "*I dëmtuari nuk ka detyrim të njoftojë Komisionerin para se të paraqesë një padi për diskriminim në gjykatë*".
10. Paditësi [REDAKTUAR], pretendon se është cënuar duke mos u trajtuar në mënyrë të barabartë si kandidatët e tjere përse i përket njohjes së vjetërsisë në punë për periudhën kur ka qënë specialist në Drejtorinë e Kodifikimit. Paditësi pretendon se KED ka mbajtur standart të dyfishtë në vendimmarrjet e saj nr.61, 62 datë 24.07.2019, nr.102, 103, 104, 105 datë 30.07.2020.
11. Paditësi pretendon se për kandidatët, sipas vendimeve respektive të KED, nuk vlen dhe nuk mund të shërbejë si bazë ligjore statusi për nëpunësin civil, i ndryshuar, por vlen vetëm spikatja si jurist në të drejtat e njeriut, ndërkohë që vetëm për paditësin, edhe pse ka qënë jurist dhe avokat në shoqërinë civile në mbrojtje të të drejtave të njeriut, nuk i është njohur kjo periudhë si vjetërsi, por është ndaluar të kandidojë për vendin vakant.

12. Në këtë situatë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, parashton këndvështrimin e Tij, vetëm përse i përket pretendimit të paditësit në lidhje me diskriminimin, trajtimin e ndryshëm në situatë të njëjtë që ka pësuar nga pala paditur KED, në kuptim të Ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin. Bazuar në faktet dhe rrethanat e çështjes, ky këndvështrim i Komisionerit synon të japë një orientim Gjykatës mbi rëndësinë e zbatimit të Ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" dhe garancitë që ai ofron.
13. Diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të ligjit, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Diferenca në trajtim qëndron në faktin se një personi apo grupi personash u krijohen vështirësi apo u bëhet e pamundur ushtrimi i të drejtave dhe lirive të njohura, në raport me të tjerët, kur të gjithë këta persona janë ndodhur në rrethana të njëjta apo të ngjashme.
14. Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi", është përfaruar plotësisht me katër direktivat e BE-së në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi. Për këtë arsye, kuptimi dhe zbatimi i tij duhet bërë në frymën e direktivave të BE-së dhe standarteve të vendosura nga Gjykata Europiane e Drejtësisë. Vendi ynë, si vend anëtar i Këshillit të Europës dhe që ka ratifikuar Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, duhet që të veprojë në përputhje me Konventën dhe me vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si organi që mbikëqyr zbatimin e saj. Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe o të barabartë.
15. Për të qënë përpara një veprimi diskriminues në kuptim të ligjit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, të njëkohshme këto kushte: të ekzistojë trajtim i diferencuar , i pabarabartë dhe i pafavorshëm, i personit në raport me të tjerët të cilët ndodhen në rrethana të njëjta të ekzistojë shkak i mbrojtur në referim të nenit.1 të ligjit trajtimi i diferencuar të ketë sjellë si pasojë vështirësinë apopamundësinë e këtij personi për të ushtruar të drejtat dhe liritë e njohura nga kushtetuta, aktet ndërkombëtare të ratifikuara, apo ligjet në fuqi.
16. Paditësi ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të pabarabarte nga pala e paditur KED, për shkak se atij nuk i është njohur si vjetërsi nëpunë, për efekt të ligjit për kandidim në Gjykatën Kushtetuese ajo periudhë në të cilën ai ka punuar si specialist në Drejtorinë e Kodifikimit pranë Ministrisë së Drejtësisë, sepse është konsideruar si nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, duke përdorur si bazë ligjore për statusin e nëpunësit civil, ndërkohë që për kandidatët e tjerë të ndodhur në të njëjtën situatë, pala e paditur, KED, në vendimmarrjet e saj nr.61, 62 datë 24.07.2019, nr.102, 103, 104, 105 datë 30.07.2020 ka mbajtur standart të dyfishtë duke mos përdorur si bazë ligjore në përlogaritjen e vjetërsisë në punë, ligjin për statusin e nëpunësit civil.
17. Në thelb të diskriminimit të drejtpërdrejtë është diferenca në trajtimin e një individi. Kështu, elementi i parë i diskriminimit të drejtpërdrejtë është të provuarit e trajtimit të pabarabarte.

18. Ligji "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" parashikon se trajtimi i pafavorshëm do të përcaktohet si diskriminim në rastet kur ai është i pafavorshëm si rezultat i krahasimit të një personi në një situatë të ngjashme. Për rrjedhojë, nevojitet një "krahasues": d.m.th. një person në rrethana materialisht të ngjashme.
19. Nga një vështrim "prima facie" i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Gjykata, kemi evidentuar se : në rastin e paditësit, pala e paditur KED ka argumentuar se në referim të ligjit nr.8549 datë 11.11.1999 "Për statusin e nëpunësit civil", detyra e specialistit klasifikohet si nëpunës civil i nivelit ekzekutiv dhe si e tillë kjo eksperiencë nuk konsiderohet si eksperiencë e juristit apo nëpunësit të lartë në administratën publike. Në rastin e një vendimmarrje tjetër (depozituar si provë në proces), për lejimin e kandidimit të një tjetër kandidati, pala e paditur në vendimin nr.102/2019, ka argumentuar se : Ligji "Për statusin e nëpunësit civil" rregullon mardhënien juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunësit civil. Prandaj dhe neni 19 i tij "Klasifikimi i pozicioneve në shërbimin civil" bën klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit duke pasur në referencë përkufizimin e ligjit "Nëpunës civilë i kategorisë së lartë drejtuese" dhe aspak kuptimin dhe përmbajtjen e shprehjes kushtetuese të nenit.125/4 "nëpunës i nivelit të lartë në administratën publike". Në këtë të fundit nuk përfshihen nëpunësit civil sipas klasifikimit që bën neni 19 i ligjit "Për statusin e nëpunësit civil". Në referim të pretendimit të paditësit, 2 janë kriteret mbi bazën e të cilit do të duhet të krahasohen rast pas rasti nominimi funksioneve të kandidatëve për të cilët paditësin është lejuar kandidimi, në zbatim të ligjit "Për statusin e nëpunësit civil" në raport me - ose do të duhet të konsiderohen rast pas rasti detyrat faktike që kanë bërë kandidatët. Gjykata do të duhet të hetojë nëse pala ligjore, si në rastin e e paditur KED, ka ndjekur të njëjtën metodikë dhe kriteret paditësit, për kandidatët e tjerë për të gjithë kandidatët , apo jo. Pra, nëse pala e paditur ka përlogaritur kandidatët e tjerë si vjetërsi në punë, në referim të nenit.125 të Kushtetutës, eksperiencën gjatë së cilës ata kanë patur emërimin e nominuar "specialist". Për të mos u nddhur para trajtimit të pafavorshëm, diskriminues, duhet që përlogaritja nga ana KED të jetë bërë njesoj për të gjithë kandidatët. Nëse gjatë hetimit provohet se pala e paditur, nuk është bazuar në kriterin nominal, KED ka barrën e provës dhe do të duhet të justifikojë faktin pse në vendimmarrjetë saj disa funksione në dukje të njëjta llogariten si vjetërsi për efekt të kandidimit, dhe disa të tjera nuk llogariten si të tilla. Në funksion të kesaj, KED duhet të parashtrroje dhe argumentojë në baze të pershkrimit të punës.
20. Shkaku i mbrojtur i diskriminimit Nga përkufizimi i diskriminimit të drejtpërdrejtë, rezulton se trajtimi më pak i favorshëm, në raport me të tjerët, duhet domosdoshmërisht të bazohet në cilindo shkak "të mbrojtur" me ligj. Gjithashtu, nevojitet një lidhje shkakësore ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur. Ligji rendit një sërë shkaqesh për të cilat, nëse diskriminohemi, mund të kërkojmë mbrojtje. Ky ligj ofron mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë joshteruese shkaqesh, përcaktuar në nenin 1 të tij. Këto shkaqe janë të natyrave të ndryshme dhe lidhen, kryesisht, me gjendjen e personit, ose në raportet e tij me shtetin, ose të tjerët. "Shkaku i mbrojtur" është karakteristika e individit që ka ndikuar lidhur me trajtimin e ndryshëm ose gëzimin e një përfitimi të caktuar. Vetë ligji, duke parashikuar shprehjen "ose me çdo shkak tjetër", afirmon se shkaqet e parashikuara në mënyrë eksplicite me ligj nuk janë të vetmet për të cilat mund të mbrohemi nga po mund të ketë edhe shkaqe të tjera.

Personi i tretë Avokati i Popullit edhe pse është njoftuar nga gjykata nuk u paraqit në seancë gjyqësore duke e lënë në mungesë.

Përsoni i tretë Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, nuk paraqiti parashtrime me shkrim iu qendroi shpjegimeve të dhëna gjatë procedimit administrativ duke kërkuar lejimin e kandidimit të paditësit për pozicionin vakant në GjK. TIRANË

III. VLERËSIMI I GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT

Ky kolegji i Gjykatës Administrative të Apelit, pasi shqyrtoi çështjen, dëgjoi palët, analizoi rrethanat faktike dhe ligjore, në përfundim çmoi se padia duhet të pranohet pjesërisht me arsyetimin si më poshtë vijon:

Së pari: gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj lëndore dhe funksionale për shqyrtimin e padisë objekt i këtij gjykimi. Në referim të nenit 7/a, nenit 10/2/b të Ligjit Nr. 49/2012, në lidhje me nenin 238 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, kjo gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

Neni 238 i Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, parashikon:

“Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit vetëm për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë”.

Rezulton se padia ka për objekt kundërshtimin e vendimit nr. 35, datë 09.10.2020, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për ndalimin e kandidimit të kandidatit [REDAKTUAR] në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallura nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë, për të cilat në bazë të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, kompetente për gjykimin e tyre është Gjykata Administrative e Apelit.

Për sa më sipër referuar dispozitave të mësipërme, kjo gjykatë është caktuar si gjykatë kompetente si nga pikëpamja lëndore ashtu edhe funksionale për shqyrtimin e kësaj padie.

Së dyti: Në lidhje me kushtet formale të padisë, siç janë legjitimimi formal i palëve, afati i ngritjes së padisë, dhe shterimi i ankimit administrativ, rezulton se nuk janë vënë në diskutim prej asnjërës prej palëve mosplotësimi i ndonjë kushti formal të padisë. Gjykata shqyrtoi kryesisht kushtet formale të padisë duke i konsideruar ato si kërkesa procedurale absolute që shkaktojnë mosshqyrtimin, e meritës së çështjes, por nuk konstatoi praninë e ndonjë pengese për shqyrtimin e themelit të çështjes.

Lidhur me afatin e ngritjes së padisë, ligji ka parashikuar afat 5 ditë për paraqitjen e padisë, afat ky që fillon nga data e marrjes dijeni për vendimin e KED. Në rastin konkret, provohet se vendimi Nr. 35 datë 09.10.2020 i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, rezulton t'i jetë komunikuar paditësit, [REDAKTUAR] në datën 21.10.2020. Sipas shënimit të vënë nga sekretaria gjyqësore në faqen e parë të padisë, rezulton se ajo është rregjistruar në këtë gjykatë në datën 23.10.2020, ç'ka tregon qartë se është brenda afatit 5 ditor.

Lidhur me shterimin e ankimit administrativ, ligji nuk ka përcaktuar ndonjë mjet tjetër ankimi përveç padisë gjyqësore, për rrjedhojë mosmarrëveshja i përket vetëm juridiksionit gjyqësor dhe asnjë autoriteti tjetër.

Ndërgjyqësia e detyrueshme rezulton të jetë e legjitimuar si aktivisht ashtu edhe pasivisht. Procedimi administrativ ka filluar me kërkesë të paditësit dhe ka përfunduar me vendimin nr. 35 datë 09.10.2020, akt ky me anë të të cilit paditësit i kufizohet e drejta e vijimit të konkurimit për anëtar të GJK, ndërsa pala e paditur gëzon legjitimim pasiv për shkak të qenies organi që ka nxjerrë aktin objekt kontestimi gjyqësor.

Së treti: Lidhur me pretendimet e ngritura në padinë e palës paditëse, Gjykata Administrative e Apelit, çmon të ndalet në radhë të parë në natyrën e këtij gjykimi dhe hapësirën që ligji i ka lënë gjykatës për të kontrolluar ligjshmërinë e akteve administrative në këto lloj gjykimesh.

Për këtë, është e nevojshme para se gjithash të prezantohen dispozitat ligjore në të cilat bazohet procedimi administrativ për përzgjedhjen e kandidatëve që do të paraqiten organit të emërtesës sipas nenit 125 të Kushtetutës.

Në nenin 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

- 1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë. Tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Anëtarët përzgjidhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas ligjit.*
- 2. Kuvendi zgjedh gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese me jo më pak se tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij. Nëse Kuvendi nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë shpallet i emëruar.*
- 3. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi.*
- 4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.*
- 5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.*
- 6. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo 3 vjet me një të tretën e saj, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.*
- 7. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në zgjedhjen e pasardhësit të tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 127, paragrafi 1, nënparagrafët "c", "ç", "d" dhe "dh".*

Në zbatim të pikave 4 dhe 5 të nenit 125 të kushtetutës, Ligji Nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në nenin 7/a, pikat 1 dhe 2 përcakton në mënyrë më të detajuar, kriteret që duhet të plotësojë një kandidat për tu emëruar Gjyqtar Kushtetues. Në këtë dispozitë parashikohet se:

- 1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:*
 - a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
 - b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;

ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral."

Me paketën e reformës në drejtësi, u miratua ndër të tjera Ligji nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë", në të cilin u parashikua procedura paraprake e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, ligj në të cilin u parashikua krijimi i organit administrativ, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, organ ky që kryen verifikimet e përmbushjes së kritereve të nenit 125 të Kushtetutës dhe nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577, datë 10.2.2000 nga personat që shprehin interes për të kandiduar për gjyqtar në GJK.

Në këtë kuadër, paditësi ka shfaqur interes duke paraqitur kandidaturën e tij, për rrjedhojë i është nënshtruar hetimit administrativ të kryer nga KED. Në aspektin procedural, procedimi administrativ për përzgjedhjen e kandidatëve, i nënshtrohet në mënyrë të posaçme dispozitave të kreut III, të Ligjit Nr. 115/2016 nenet 226-240, rregullores së posaçme të miratuar me Vendimin Nr. 4 datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", pa iu shmangur parimeve dhe rregullave të përgjithshme të parashikuara në K.Pr.Administrative, për aq sa ato janë të zbatueshme.

Në aspektin procedural, në nenin 228 të Ligjit Nr. 115/2016, është parashikuar caktimi me short i një anëtari të Këshillit të quajtur **relatori**, për të udhëhequr hetimin administrativ për çdo vend vakant, i cili pasi kryen të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, në përfundim i paraqet këshillit një relacion mbi gjetjet e konstatuara.

Neni 228, Relatori

1. Për verifikimin paraprak të plotësisë së kushteve ligjore dhe vlerësimin e kritereve profesionale e morale nga kandidatët, si dhe për renditjen e tyre, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi cakton me short një relator për pozicionet vakante në çdo institucion.

2. Shorti për caktimin e relatorit organizohet përmes sistemit të administrimit të çështjeve të Gjykatës së Lartë.

3. Përfundimisht, në qoftë se sistemi elektronik nuk funksionon, shorti mund të kryhet manualisht. Këshilli miraton rregulla më të detajuara për të bërë të mundur që procedura e shortit për caktimin e relatorit t'u përmbahet parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të procesit.

4. Rezultati i shortit për relatorin bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

5. Për zhvillimin e procedurës së verifikimit, vlerësimin dhe renditjes, relatori kryen detyrat e mëposhtme:

- a) shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit të depozituar nga kandidatët;
- b) kërkon kontrollin pasurisë së kandidatëve dhe verifikimin e rekordeve penale dhe disiplinore të tyre;
- c) përgatitjen e projekt daktit të verifikimit, vlerësimit dhe të renditjes së kandidatëve;
- ç) koordinimin me kryetarin për përgatitjen e mbledhjes së Këshillit;
- d) përgatitjen e komunikatës për mediat;
- dh) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj. 6. Në ushtrimin e përgjegjësive të tij, relatori ndihmohet nga personeli administrativ i Gjykatës së Lartë.

Në nenin 229 të Ligjit Nr. 115/2016 është parashikuar, mënyra e ushtrimit të veprimtarisë dhe e vendimmarrjes nga ana e Këshillit.

Neni 229 ka këtë përmbajtje.

1. Këshilli e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë kre, të cilat, plotësohen, për aq sa është e mundur dhe me ndryshimet e nevojshme, nga rregullat e parashikuara në legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale. Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit është e detyrueshme. Anëtarët që mungojnë zëvendësohen nga anëtarët zëvendësues.
2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për të siguruar zhvillimin e një procedure transparente, publike dhe bazuar në merita, me vendim, miraton rregulla më të detajuara për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve, duke përfshirë edhe rregullat për procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale dhe personale të tyre.
3. Këshilli vendos me shumicën e votave në prani të të paktën pesë anëtarëve.
4. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në procesin e verifikimit të plotësisimit të kushteve ligjore dhe të vlerësimit të kriterëve profesionale e morale kërkon informacione nga institucione të tjera.
5. Në përfundim të procesit të verifikimeve, sipas pikës 4, të këtij neni, Këshilli interviston kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore, bën renditjen e tyre sipas kriterëve të parashikuara në nenin 240, të këtij ligji, dhe harton një raport ku arsyeton këtë renditje.

Procedimi administrativ, nis me paraqitjen para KED të listës së kandidatëve. Sipas rastit, lista paraqitet nga; i) Presidenti i Republikës; ii) Kuvendi dhe; iii) Kryetari i Gjykatës së Lartë. Pra këto janë tre subjektet që mund të vënë në lëvizje procedimin administrativ pranë KED. Lidhur me këtë, **neni 234, i Ligjit Nr 115/2016 parashikon:**

Subjektet që vënë në lëvizje Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

1. Presidenti i Republikës i dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi listën e plotë të kandidatëve që kanë publikimit shprehur interes për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të cilat plotësohen nga Presidenti i Republikës, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, menjëherë pas të listës së kandidatëve në faqen zyrtare të Presidentit.
2. Kryetari i Kuvendit i dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi listën e plotë të kandidatëve që kanë shprehur interes për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të cilat plotësohen nga Kuvendi, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, menjëherë pas publikimit të listës së kandidatëve në faqen zyrtare të Kuvendit.
3. Kryetari i Gjykatës së Lartë i dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi listën e plotë të kandidatëve që kanë shprehur interes për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të cilat plotësohen nga Gjykata e Lartë, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, menjëherë pas publikimit të listës së kandidatëve në faqen zyrtare të gjykatës

Në vijim, relatori kryen hetime aktive për secilin kriter në referim të neneve 235, 236 e 237 të Ligjit Nr. 115/2016.

Për rastin konkret gjykata çmon ti referohet përcaktimeve të nenit 237 të Ligjit Nr. 115/2016 dhe dispozitave të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4 datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", në të cilat normohet procedura e hetimit administrativ në përgjithësi dhe për kriterin e përvojës profesionale në veçanti, meqenëse mosmarëveshja objekt gjykimi ka të bëjë pikërisht me këtë kriter.

Neni 237 parashikon

Deklarimi dhe kontrolli i kushteve të tjera ligjore

1. Jo më vonë se 35 ditë nga mbërritja e listave të kandidatëve dhe dokumenteve që i shoqëron ato, Këshilli për Emërimet në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore të parashikuara në ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në nenin 234, pika 1, të këtij ligji.
2. Për këtë qëllim Këshilli dërgon kërkesa me shkrim në adresë të subjekteve publike dhe private, sipas nevojës.
3. Me përfundimin e procedurës së verifikimit, Këshilli shpall në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe u komunikon individualisht kandidatëve rezultatit e verifikimit të kushteve ligjore, duke urdhëruar lejimin ose ndalimin e kandidimit.

Siç shihet, nga përmbajtja dhe interpretimi tekstual dhe logjik i dispozitës së lart cituara, ligji ka përcaktuar tre momente të rëndësishme procedurale nëpër të cilat duhet të kalojë detyrimisht procedimi administrativ nga paraqitja e kërkesës deri në dhënien e vendimit për lejimin ose ndalimin e kandidimit të kandidatit.

- i) Paraqitja e interesit nga subjekti dhe përcjellja e kërkesës nga subjektet që vënë në lëvizje KED;
- ii) Kryerja e veprimeve verifikuese (faza e hetimit administrativ) nga relatori; dhe
- iii) Marrja e vendimit nga Këshilli sipas rregullave të funksionimit të organeve kolegjiale.

Lidhur me procedurën, në Vendimin Nr. 4 datë 11.03.2019, të KED, "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", janë parashikuar rregulla më të detajuara, por gjykata duke pasur parasysh rastin konkret, ku pretendimi themelor ka të bëjë me shkelje në fazën e hetimit administrativ, çmon të përzgjedhë për t'iu referuar këto dispozitave të rregullores Nr 4:

Në kreun II, janë parashikuar, rregulla të përgjithshme të procedurës së verifikimit.

A. Fillimi dhe fazat e procedurës së verifikimit.

5. Procedura administrative e verifikimit të kandidatëve realizohet në dy faza:
 - a) veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit;
 - b) shqyrtimi dhe miratimi i projekt aktit të verifikimit nga Këshilli.

B. Të drejtat e kandidatit.

6. Kandidati ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së verifikimit, me kërkesën e tij, të njihet me dokumentet e dosjes së kandidimit dhe aktet procedurale të kryera nga relatori dhe Këshilli për verifikimin e kandidaturës, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative dhe atyre të përcaktuara në këtë Vendim.
7. Kryesisht apo mbi kërkesën e Këshillit, kandidati ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore të lidhura me kandidimin e tij/saj, si dhe të depozitojë dokumente shkresore shtesë, në mbështetje të këtyre shpjegimeve.

Kreu III. Fazat e procedurës administrative të verifikimit të kandidatëve.

A. Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit.

20. *Krahas veprimeve procedurale dhe verifikuese të tjera që i vlerëson të nevojshme rast pas rasti, për secilin kandidat relatori realizon procedurat standarde si më poshtë:*
- a) *pajisjen e kandidatit me formularin "Deklaratë e pasurisë dhe interesave private"*
 - e) *dërgimin e shkresave standarde për kërkimin e informacionit dhe të shpjegimeve përkatëse nga kandidati, institucionet publike dhe subjektet private, në lidhje me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.*
23. *Nëse nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga secili kandidat, relatori konstaton dhe vlerëson se është i paplotë, njofton menjëherë kandidatin për të përmbushur detyrimin e plotësimit të tij sipas ligjit, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë për dorëzimin e tij pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë. Kur i vlerëson të justifikuar motivet, e paraqitura nga kandidati për mospërmbushjen e detyrimit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar brenda afatit 5 ditor, relatori i cakton një afat të ri të arsyeshëm.*
24. *Pas realizimit të procedurave të parashikuara në pikat 22 dhe 23 të këtij Vendimi, relatori procedon me dërgimin e shkresave standarde për kërkimin e informacionit dhe të shpjegimeve përkatëse nga kandidati, institucionet publike dhe subjektet private, në lidhje me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.*
25. *Në procedurën e verifikimit, relatori shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga secili kandidat, formularët e deklarimeve të plotësuara, aktet e dërguara nga organet e ngarkuara me ligj për kontrollin dhe verifikimin e deklarimeve të kandidatëve, si edhe çdo akt, informacion dhe të dhënë tjetër të dërguar nga subjektet publike dhe private, me nismën e tyre ose mbi kërkesën e Këshillit apo që relatori vlerëson se ka lidhje me gjykimin mbi plotësimin ose jo të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore për kandidim.*
26. *Bazuar në gjetjet e procedurës së verifikimit, nëse vlerëson paraprakisht që mund të procedohet me urdhërimin e lejimit ose të ndalimit të kandidimit, relatori njofton kandidatin e verifikuar lidhur me gjetjet paraprake, si edhe për të drejtën që:*
- a) *brenda një afati 5 ditor nga dita e njoftimit, të paraqesë me shkrim, drejtpërdrejt pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë ose në rrugë elektronike, qëndrimin dhe shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit, si edhe të dokumentacionit mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të kandidatit;*
 - b) *të tërheqë, sipas rastit, kopje të dokumentacionit dhe të akteve të këtij procedimi administrativ ose të asaj pjesë të tyre që lidhet me verifikimin e kushteve dhe kriterëve përkatëse ligjore për të cilat relatori ka vlerësuar paraprakisht se mund të sjellin ndalimin e kandidimit.*
29. *Nëse në përfundim të këtyre procedurave administrative për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, relatori vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen e çështjes dhe të relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.*
30. *Nëse vlerëson që kandidati nuk përmbush ndonjërin prej kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, relatori procedon me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit, pa qenë i nevojshëm kryerja e procedurës së verifikimit për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore.*
48. *Në rastin kur, pas shqyrtimit të relacionit dhe të akteve që përmban dosja e kandidatit të verifikuar, Këshilli vjen në përfundimin që ka vend për të vlerësuar edhe mundësinë e*

ndalimit të kandidimit, por në atë çështje nuk janë ndjekur procedurat e përcaktuara në pikat 22 deri në 27 të këtij Vendimi, shpall caktimin e një seance tjetër për shqyrtimin e çështjes. Kandidatit të verifikuar i njoftohet materiali me gjetjet dhe motivet të cilat mund të sjellin ndalimin e kandidimit. Kandidati ka të drejtën e parashtrimit me shkrim të shpjegimeve të tij dhe dokumenteve mbështetës, jo më vonë se 5 ditë nga dita e ardhjes në dizeni të materialit të dërguar nga Këshilli.

50. Në rastet e tjera, pas bisedimit dhe votimit të çështjes në dhomën e këshillimit, Këshilli vendos: a) lejimin e kandidimit; b) ndalimin e kandidimit; c) vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.
51. Këshilli vendos ndalimin e kandidimit nëse kandidati nuk përmbush qoftë edhe njërin nga kushtet ose kriteret e tjera ligjore të kandidimit, duke u bazuar në të dhënat që përmbajnë: a) deklarimet dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati; b) gjetjet dhe përfundimet e organeve kompetente të kontrollit të pasurisë dhe të integritetit të kandidatit, si edhe informacionet e subjekteve të tjera publike dhe private dërguar në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit.

Në nenin 238 të Ligjit Nr. 115 2016, parashikohet mundësia e kontrollit gjyqësor të aktit që nxjerr KED në përfundim të procedurës së lart cituar, nepërmjet njohjes së të drejtës së ankimit gjyqësor kundër vendimeve të KED në Gjykatën Administrative të Apelit.

Neni 238

Ankimet kundër vendimeve për ndalimin e kandidimit.

1. Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit vetëm për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar.
2. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë.
3. Ankimi nuk pezullon zhvillimin e procedurës së vlerësimit dhe të verifikimit paraprak të kryer nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas nenit 240 të këtij ligji.

Sikurse shihet qartësisht nga përmbajtja e pikës 1 të nenit 238, subjektet të cilëve iu ndalohej kandidimi, kanë të drejtën e ankimit në gjykatë, por kontrolli gjyqësor në këtë rast kufizohet vetëm në rrethana që kanë të bëjnë me procedurën dhe veçanërisht nëse procesi është rrjedhojë e ndonjë shkelje të rëndë procedurale.

Për të konkluduar mbi natyrën e pavlefshmërisë që pretendon pala paditëse, ky kolegji gjen momentin të ndalet shkurtimisht në format e shfaqjes së pavlefshmërive së akteve administrative.

Paligjshmëria e aktit administrative shfaqet në dy forma: i) në formën e mungesës së plotë veprimi juridik nga akti administrativ e cila njihet si pavlefshmëria absolute (nuliteti i plotë); dhe, ii) në formën e një akti që prodhon pasoja juridike deri në momentin që konstatohet paligjshmëria e tij, njohur si pavlefshmëria relative apo kundërligjshmëria e aktit.

Pavlefshmëria absolute e aktit administrative, është ajo gjendje juridike ku shkelja e ligjit është thelbësore, e tillë që akti konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar asnjëherë. Kjo paligjshmëri lidhet si me organin, aftësinë e tij për të ushtruar të drejtën apo kompetencën e nxjerrjes së aktit, ashtu edhe me rregullsinë e procesit, pra më procedurat paraprake që duhet të ndiqen deri në nxjerrjen e aktit.

Ky kolegji i Gjykatës Administrative të Apelit vlerëson se, procedura e nxjerrjes së aktit administrative, është garanci për palët e përfshira në një procedim administrative se çështja e tyre do të vlerësohet drejtësisht dhe paanshmërisht dhe se organi administrative do të nxjerrë një akt të ligjshëm dhe të themeltë, në përputhje në mes gjendjes faktike dhe juridike. Nëse organi administrative nuk zbaton procedurën e parashikuar nga ligji, produkti i veprimtarisë administrative (akti apo veprimi tjetër administrativ), nuk jep garancinë e duhur tek palët, se të drejtat e tyre janë respektuar, së normat material janë zbatuar drejt, apo se garantohet e drejta për siguri juridike.

Natyrisht nuk është e lehtë në praktikë të ndahet shkalla e shkeljes së ligjit për të përcaktuar paligjshmërinë apo nulitetin e aktit, pasi në çdo rast kërkohet shkelje e rëndë që të sjellë parregullsinë e procesit dhe jo çdo lloj shkelje, por në rrethana të caktuara një shkelje mund të marrë rëndësi të veçantë për rrjedhojë gjykata duhet të tregohet e kujdesshme në vlerësimin e çdo rrethane për të konkluduar mbi llojin e pavlefshmërisë së aktit.

Kodi i Ri i Procedurave Administrative në nenet 108 dhe 109 të tij, në dallim nga kodi i mëparshëm ka sjell risi në këtë drejtim, duke futur konceptin paligjshmëri e aktit dhe përcaktuar edhe listën e rrethanave që sjellin këtë lloj paligjshmërie, ndër të cilat edhe shkeljet e dispozitave në procedurë, duke bërë edhe dallimin ndërmjet pavlefshmërisë absolute dhe relative, nisur nga shkalla dhe rëndësia e shkeljes së ligjit.

Gjykata e ka të qartë se, jo çdo shkelje e procedurës sjell pavlefshmërinë absolute të aktit. Në praktikë është pranuar se shkelja e procedurës duhet të jetë e asaj shkalle dhe rëndësie sa që, nëse procedura do të ishte respektuar, organi administrative nuk do të kishte shfaqur vullnetin e tij në atë formë. Në këtë rast, akti konsiderohet i vesuar pasi vullneti i organit administrative në nxjerrjen e këtij akti mbetet gjithmonë i dyshimtë. Nuk mund të sjellje pasojat e dëshiruara juridike një akt i cili nuk vjen si rezultat i shprehjes së qartë dhe të plotë të vullnetit të organit administrative për të krijuar, ndryshuar apo shuar një marrëdhënie juridike në fushën administrative. Vullneti i organit administrativ nuk mund të vije në kundërshtim me ligjin, për rrjedhojë shkelja e procedurës në fund të fundit do të çonte në zbatimin e gabuar të normave materiale, duke shtrembëruar qëllimin dhe përmbajtjen e ligjit dhe cenuar thelbin e të drejtës. Kjo për faktin se shkelja e procedurës rrezikon të deformojë vullnetin e organit administrativ, për pasojë shprehja e vullnetit të organit administrative nuk do të jetë shprehje e vullnetit të ligjvënësit e pasqyruar në normat e ligjit.

Referuar përcaktimit të **nenit 238 të Ligjit Nr. 115/2016**, në të cilin kërkohet **shkelje e rëndë e procedurës** që të sjellë si pasojë pavlefshmërinë e aktit, përcaktimeve të **nenit 108 të K.Pr.Administrative** në të cilin përdoret termi **shkelje flagrante** e ligjit në procedurë që akti të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm; dhe **nenit 109 të K.Pr.Administrative**, në të cilin përcaktohet **shkelja e dispozitave lidhur me procedurën administrative**; (pa definuar ndonjë term në kuptimin e shkallës së rëndësisë apo flagrancës), që akti të konsiderohet relativisht i pavlefshëm, gjykata çmon se, ligjvënësi në rastin konkret, nisur nga fakti që e ka kufizuar në kohë afatin e ngritjes së padisë një rrethanë kjo që lidhet vetëm me pavlefshmërinë relative, pasi pavlefshmëria absolute mund të konstatohet në çdo kohë, ka pasur në konsideratë atë shkallë të shkeljes së procedurës që nuk mund të jetë e karakterit flagrant por e shkallës së rëndë që e bën procesin të pavlefshëm/anulueshëm nga pikëpamja juridike.

Ligji Nr. 115/2016, kur ka përcaktuar kufijtë e shqyrtimit të këtyre lloj mosmarrëveshjes, ka cilësuar që vetëm procedura mund të verifikohet nga gjykata, duke përdorur termin “

shkelje e rëndë”. E ka vënë theksin në këtë lloj shkelje procedurale, për të kufizuar procesin e verifikimit gjyqësor vetëm në shkelje të rënda të procedurës dhe jo çdo lloj shkelje procedurale që nuk mund të ndikojë rezultatin, por në asnjë rast nuk e ka njehsuar shkeljen e rëndë me gjendjen e flagrancës, apo ti ketë dhënë kuptim sipëror (p.sh shumë të rëndë). Natyrisht duket qartë se, ka përjashtuar nga kontrolli gjyqësor çdo lloj paligjshmërie tjetër të natyrës së interpretimit të fakteve dhe zbatimit të ligjit material.

Duke iu rikthyer në rastit konkret, rezultojnë e provuar se, pala e paditur pasi ka kryer fillimisht verifikimet e nevojshme në kriterin e pasurisë të integritetit të kandidatit si dhe kritere të tjera të përcaktuara në pikën 1 të nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, dhe nuk ka gjetur shkak ndalues për vijimin e kandidimit të paditësit, ka riçelur procedurën administrative duke vijuar verifikimin në kriterin “Përvojë profesionale”, sipas përcaktimeve të nenit 237, të Ligjit Nr. 115/2016, dhe pikës 2, të nenit 7/a, të Ligjit Nr. 8577, datë 10.2.2000.

Kështu, në pikën 36 të vendimit nr 35 datë 09.10.2020, KED shprehet ndër të tjera se; “Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit Nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit Nr. 4 datë 11.03.2019, duke vlerësuar paraprakisht të përfunduar procedurën e verifikimit, anëtar i Këshillit, relator i çështjes ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit duke propozuar që, për shkak të rëndësisë aktuale që ka shqyrtimi i kandidaturave për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese, edhe ky relacion të shtohet në rendin e ditës së mbledhjes së KED-së të datës 05.10.2020, ora 13:00, në vijim të shqyrtimit të gjetjeve në procedurën e verifikimit edhe për kandidatët e tjerë të kësaj vakance.

Pasi ka marrë në shqyrtim këtë propozim të relatorit, në mbledhjen e datës 05.10.2020, Këshilli paraprakisht miratoi përfshirjen në rendin e ditës edhe shqyrtimin e çështjes për kandidatën [REDAKTUAR]. Më pas, gjatë shqyrtimit të kësaj kandidature, këshilli pasi ka konstatuar se nuk është kryer hetim i plotë lidhur me kriterin e përvojës profesionale, me vendimin e datës 05.10.2020, bazuar ndër të tjera në germën “c” të pikës 50 të Vendimit Nr. 4 datë 11.03.2019 të KED, ka vendosur: “**Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidaturës së z. [REDAKTUAR], lidhur me kushtin ligjor të vjetërsisë në punë, dhe thirrjen e mbledhjes së radhës në datën 09.10.2020**” .

Në pikën 50 të Vendimit Nr. 4 datë 11.03.2019 të KED, është parashikuar; pas bisedimit dhe votimit të çështjes në dhomën e këshillimit, Këshilli vendos: a) lejimin e kandidimit; b) ndalimin e kandidimit; c) vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit. Pra, këshilli ka vijuar procedurën e verifikimit vetëm për kriterin “Përvojë profesionale”, pasi për këtë kriter e ka gjetur verifikimin jo të plotë, duke mos vendosur ndalimin e kandidimit sipas germës “b” të pikës 50 të rregullores për ndonjë nga kriteret e verifikuara, megjithëse sipas pikës 30 të kësaj rregulloreje, ka qenë në kushtet për ta marrë një vendim të tillë në mbledhjen e datës 05.10.2020. Sikurse rezultojnë edhe nga përmbajtja e vendimit, hetimi administrativ për kriteret pasuri, integritet dhe disa kritere të tjera është i plotë dhe gjen pasqyrim në vendim.

Lidhur verifikimet për kriterin, “Përvojë profesionale” rezultojnë se, me datë 06.10.2020 KED ka njoftuar me email kandidatën lidhur me vendimmarrjen e datës 05.10.2020, duke i bërë të qartë nepërmjet email-it se, do të vijojë verifikimi për kriterin ligjor 15 vjet

vjetërsi. Nepërmjet këtij komunikimi, i është kërkuar paditësit që të japë sqarime lidhur me përmbushjen e këtij kushti ligjor për veprimtaritë e ushtruara nga ai dhe të deklaruara prej tij, ndër vite.

Paditësi ka dhënë sqarimet e tij nepërmjet email-t me datë 07.10.2020, duke i shoqëruar shpjegimet edhe me akte shkresore si; kopje të licencës së avokatit të vitit 2002 dhe 2003 dhe një kopje të listës së regjistrit themeltar Nr. 115 të Gjykatës Kushtetuese mbi të dhënat teknike të punësimit të nëpunësit.

Në shpjegimet e tij ndër të tjera paditësi ka sqaruar se;

- *Unë e plotësoj këtë kriter ligjor dhe se ky fakt provohet edhe në dokumentacionin e administruar në dosjen e kandidatit;*
- *Sipas interpretimeve të bëra në Vendimin Nr. 102, datë 30.07.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke konkluduar se togfjalëshi "nëpunës i lartë në administratën publike" nënkupton evidentimin e atyre nëpunësve të administratës publike që dëshmojnë një nivel të lartë të veprimtarisë së spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës;*
- *Duke pasur parasysh këtë interpretim të KED, vlerësoj se me eksperiencën time, jo vetëm që jam marrë me fusha të ndryshme të së drejtës, përfshirë të drejtën kushtetuese dhe të drejtat e njeriut, por vlerësoj se kam treguar një nivel të lartë të profesionalizmit gjatë ushtrimit të funksioneve të ndryshme;*
- *Pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës Kushtetuese, nga janari 2018 e në vijim, përbën formalisht dhe substancialisht pozicionin e juristit të lartë në administratën publike;*
- *Këshilltari i Gjykatës Kushtetuese, nga maji 2013 deri në dhjetor 2017, parashikohet shprehimisht në Nenin 7/a të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese;*
- *Ndihmësi ligjor në Gjykatën e Lartë, nga maji 2005 – maj 2013, parashikohet shprehimisht në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese;*
- *Sipas interpretimeve të bëra në Vendimin Nr. 102, datë 30.07.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke konkluduar se togfjalëshi "nëpunës i lartë në administratën publike" nënkupton evidentimin e atyre nëpunësve të administratës publike që dëshmojnë një nivel të lartë të veprimtarisë së spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës;*
- *Ka pasur si objekt veprimtarie hartimin e projektligjeve dhe akteve nënligjore normative, përgatitjen e mendimeve juridike mbi ligjet apo aktet nënligjore normative etj, duke konkluduar se ky pozicion duhet të përfshihet në kërkesën e Nenit 7/a të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese;*
- *Duhet të mbahet parasysh se këtë qasje interpretative ka mbajtur edhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi;*
- *Për periudhën nëntor 2001 dhe Janar 2004 kam ushtruar profesionin e avokatit, sipas licencës Nr. 1389, datë 15.11.2001, të provuara nga vërtetimet e shoqatave të të drejtave të njeriut dhe librezës së punës apo pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pasi kam qenë si i vetëpunësuar;*
- *Nuk kam ushtruar gjatë kësaj periudhe vetëm profesionin e avokatit por kam qenë i angazhuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut;*
- *Për rrjedhojë, duke pasur parasysh edhe tabelën e të dhënave, konkludohet se plotësoj kushtin e vjetërsisë 15 vjeçare, pasi gjithsej kam 18 vjet, 1 muaj dhe 2 ditë vjetërsi*

Me këtë veprim procedural, pra me marrjen e shpjegimeve nga kandidati, zv. Kryetari i KED, ka thirrur mbledhjen e Këshillit, duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 09.10.2020, ora 14.00, duke njoftuar rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës, është përfshirë çështja me objekt shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatin [REDAKTUAR], për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4 datë 11.03.2019, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin përfundimtar të përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidati [REDAKTUAR].

Bazuar në verifikimet e sipërcituara, këshilli ka konkluduar se, kandidati [REDAKTUAR] nuk plotëson kushtin e parashikuar nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "a" e pikës 2 të Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000, përvojë punë të paktën 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike.

Në këto rrethana, në mbledhjen e datës 09.10.2020, Këshilli pasi ka diskutuar mbi kandidatin [REDAKTUAR], me vendimin objekt ankimi, ka vendosur ndalimin e kandidimit të tij për vendin vakant, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019, për mosplotësim të kriterit përvojë pune.

Bie në sy fakti se në marrjen e këtij vendimi ka pasur edhe një mendim paralel nga dy anëtarë, të cilët pasi kanë deklaruar votën pro ndalimit të kandidimit për kriterin përvojë punë të paktën 15 vjet, kanë vlerësuar se ndalimi i kandidimit duhej të bëhej edhe për kriterin e integritetit, ç'ka e bën procesin e votimit dhe të vendimmarrjes të paqartë. Nga njëra anë është vijuar verifikimi vetëm për kriterin e vjetërsisë në punë, nga ana tjetër duket se është vënë në diskutim edhe kriteri i integritetit, por që ndalimi i kandidimit është vendosur vetëm për kriterin e vjetërsisë. Pra, vetë pala e paditur është kontradiktore në vendimmarrjen e saj, pasi në vendimin e datës 05.10.2020, është vendosur vijimi i verifikimit të kandidaturës së [REDAKTUAR] vetëm lidhur me kushtin ligjor të vjetërsisë në punë, duke nënkuptuar se për kriteret e tjera të verifikuara me parë, nuk është gjetur kusht ndalimi për vijimin e kandidimit. Megjithatë mendimi paralel lë të kuptohet se, janë shqyrtuar edhe një herë të gjitha kriteret dhe në përfundim është vendosur ndalimi vetëm për kriterin 15 vjet vjetërsi në punë.

Rezultoni se pala e paditur, nuk i ka njohur paditësit përvojat e punës si avokat për periudhën **nëntor 2001 - Janar 2004** dhe Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë për periudhën **Janar 2004 – Maj 2005**.

Sipas palës së paditur, për tu konsideruar përvojë pune për efekt të plotësimit të kriterit të përcaktuar në nenin 125 të Kushtetutës dhe pikës 2, germa "a" të nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, ushtrimi i profesionit të avokatit, duhet që kandidati jo vetëm të ketë qenë i pajisur me licencën e avokatit, por edhe ta ketë ushtruar realisht këtë profesion.

Ndërsa lidhur me periudhën, Janar 2004 – Maj 2005, si specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, pala e paditur ka vlerësuar se kjo eksperiencë nuk konsiderohet si eksperiencë e juristit apo nëpunësit të nivelit të lartë në administratën publike. Këtë konkluzion e bazon në klasifikimin e pozicioneve të punës nga Ligji Nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", i cili ka qenë në fuqi në kohën që kandidati ka qenë duke ushtruar detyrën "Specialist".

Lidhur me vlerësimin e këtij kriteri, gjykata konstaton se, nga ana e organit administrativ KED, është lejuar shkëlqje e rënda në procedurë, shkëlqje e cila konsiston në mos kryerjen e hetimit administrativ sikurse kërkohet nga pika 4 e nenit 229, pika 2 e nenit 237 të Ligjit Nr. 115/2016 dhe pikat 20/e, 23 -26 të Vendimit Nr. 4 datë 11.03.2019, të KED, "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Karrierës të Drejtësisë".

Kështu në zbatim të këtyre dispozitave procedurale, për të arritur në një vendim të drejtë dhe të pakontestueshëm nga pikëpamja procedurale, organi administrative KED, zhvillon procedurën në dy faza, ku njëra është ajo e verifikimit të kriterëve **profesionale e morale**. Ky hetim zhvillohet nepërmjet relatorit të zgjedhur për çdo vakancë, i cili kryen hetim proaktiv duke **kërkuar informacione nga institucione të tjera, nepërmjet kërkesave me shkrim në adresë të subjekteve publike dhe private, sipas nevojës (shih pikën 4 të nenit 229 dhe pikën 2 të nenit 237 të Ligjit Nr. 115/2020)**, dhe vetëm pas ezaurimit të plotë të kësaj faze mund të kalohet në fazën e dytë atë të vendimmarrjes.

Gjatë gjithë fazës së verifikimit, kandidati ruan të drejtën e njohjes me dokumentet e dosjes së kandidimit dhe aktet procedurale të krijuara nga relatori dhe Këshilli për verifikimin e kandidaturës, të paraqesë shpjegime me shkrim për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore të lidhura me kandidimin e tij/saj, si dhe të depozitojë dokumente shkresore shtesë, në mbështetje të këtyre shpjegimeve (shih kreun II pika B të rregullores).

Në kundërshtim me sa parashikohet në këto dispozita, pala e paditur pasi ka riçelur hetimin administrativ i cili ishte mbyllur një herë dhe kandidatura e paditësit ishte caktuar të shqyrtohej në mbledhjen e datës 05.10.2020 sipas relacionit të njoftuar paditësit në datën 02.10.2020, ka kryer vetëm një veprim në funksion të verifikimit të përvojës profesionale. Konkretisht ka marrë vetëm shpjegimet e paditësit i cili i ka bërë të ditur palës së paditur përvojën e tij profesionale, duke cituar pozicionet e punës ku kishte punuar deri në paraqitjen e kandidaturës. Lidhur me përvojën si avokat në periudhën nëntor 2001 - Janar 2004, periudhë kjo e panjohur nga pala e paditur, paditësi përveç librezës së punës të paraqitur më parë, bashkë me shpjegimet ka dorëzuar edhe licensën e avokatit duke vlerësuar se me këto akte provohet përvoja e punës si avokat në përbërje të Grupit Shqiptar të të Drejtave të Njeriut.

Pala e paditur, pa kërkuar asnjë informacion tjetër në institucione publike a private ku paditësi orientonte në shpjegimet e tij, ka mbyllur procedimin duke i njoftuar në datë 7.10.2020 paditësit relacionin, i cili nuk ka ndonjë ndryshim me relacionin e mëparshëm, ku nuk thuhet asgjë lidhur me mangësitë në dokumentacion apo gjetjet në aspektin e përvojës profesionale, cilat periudha i njihen dhe cilat jo, përse i njihet një periudhë dhe përse nuk i njihet një periudhë tjetër etj.

Pala e paditur në arsyetimin e faktit që periudha e punës si avokat dhe ajo si specialist në MD nuk i njihet për efekt të përvojës profesionale për të vijuar kandidimin për gjyqtar në GJK, mjaftohet vetëm me deklarinimin se, funksionet e ushtruara nga paditësi gjatë karrierës së tij në periudhën 1994 – Qershor 2005 kanë të bëjnë me një përvojë pune të kandidatit që nuk përfshihet në rrethin e atyre të përcaktuara nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës apo pika 2 e Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000. Sipas , palës së paditur vetë kandidati nuk sqaron nëse ka qenë i regjistruar pranë QKB për ushtrimin e këtij profesioni, ndërsa nga të dhënat e raportit përfundimtar të ILDKPI-së nuk rezulton regjistrimi i tij në organet tatimore

për ushtrimin e profesionit të avokatit. Pra del qartë se vendimi bazohet në të dhëna të paverifikuara nëse qëndrojnë apo jo.

Megjithëse paditësi ka pretenduar se, ka ushtruar efektivisht profesionin e avokatit në periudhën 2001-2004, pranë Grupit Shqiptar të të Drejtave të Njeriut, pala e paditur ia rrëzon këtë pretendim pa kryer asnjë verifikim mbi këtë fakt, por edhe pa arsyetuar në mënyrë të qartë se çfarë kupton me ushtrimin real të profesionit të avokatit. Po ashtu edhe për periudhën e punës si specialist në zyrën e kodifikimit, nuk rezulton të jetë kërkuar ndonjë informacion pranë institucionit ku ka kryer këtë punë, apo në ndonjë institucion tjetër publik i cili mund të sqarojë në lidhje me faktin nëse duhet të klasifikohet puna e kryer pranë Ministrisë së Drejtësisë si eksperiencë e juristit apo nëpunësit të nivelit të lartë në administratën publike apo jo.

Pala e paditur, në funksion të një procesi të rregullt ligjor, ishte e detyruar që jo vetëm të kryente një hetim të plotë e të gjithanshëm lidhur me kriterin për të cilin ka rihapur procesin e vlerësimit pa e paragjykuar çështjen dhe, pa nënvlerësuar apo mbivlerësuar asnjë provë apo fakt të çështjes, por në zbatim të parimit të kontradiktoritetit si një nga parimet më të rëndësishme jo vetëm në kontestet gjyqësore por edhe në procedimet administrative, duhej ti njoftonte paditësit çdo gjetje që çonte në ndalimin e kandidimit me qellim që ti jepej mundësia të ushtronte të drejtën e paraqitjes së argumenteve shtesë apo provave në dobi të procesit.

Rezulton se, pas dhënies së shpjegimeve nga kandidati lidhur me vjetërsinë në punë, paditësit nuk i është dhënë asnjë informacion nëse në dokumentacionin e tij ka mangësi apo arsytet përse ndonjë prej periudhave të deklaruara prej tij nuk përfshihet në përvojën e kërkuar, me qellim që ai të paraqiste kundërshtimet e tij para se të merrej vendimi.

Gjykata e ka të qartë se, vlerësimi i fakteve sa i përket verifikimit të kriteve është në diskrecion të plotë të palës së paditur e cila ka një hapësirë të gjerë vlerësimi dhe zgjedhjeje, por kjo e drejtë diskrecionare nuk mund të ushtrohet përveçse nepërmjet një procesi të rregullt ligjor, duke iu përmbajtur detyrimeve procedurale me qellim që gjetjet të bazohen në prova të siguruar në mënyrë të ligjshme.

Sipas parimit të ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit (Neni 11 i K.Pr.A), zgjedhja e organit publik duhet të bëhet vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe, zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme, në të kundër ushtrimi i të drejtës diskrecionare konsiderohet i paligjshëm për rrjedhojë edhe produkti administrativ që rrjedh nga shkelja e këtij parimi është i pavlefshëm. Në kuptim të këtij parimi, pala e paditur duhet të vendose një standard të qartë për çdo çështje të gjykuar, me qellim që e njëjta praktikë të zbatohet në raste të ngjashme. Me mënyrën si ka arsyetuar rastin e paditësit, nuk del në pah asnjë konkluzion i qartë se për çfarë arsye nuk i njihet paditësit përvoja e punës si avokat, apo se në cilat prova bazohet ky konkluzion, ndërkohë që qenia avokat është një nga përvojat që njihet si vjetërsi nga ligji dhe kushtetuta.

Duke shmangur tërësisht një moment të rëndësishëm të procedurës, sikurse është ajo e verifikimit të kriteve nepërmjet një hetimi të plotë e të gjithanshëm administrativ, pala e paditur i ka kufizuar në mënyrë të padrejtë dhe paarsyeshme paditësit të drejtën e vijimit të konkurimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Ky moment procedural merr rëndësi të veçantë kur bëhet fjalë për një periudhe të shkurtër përvojë punë që paditësit i

duhej për të kaluar kriterin përvojë profesionale dhe vijuar konkurimin. Pra, pala e paditur nuk ka qenë në rrethana të tilla që hetimi mbi këtë periudhë punë nuk kishte rëndësi të vecantë për paditësin e për rrjedhojë të konsiderohet shkelje e lehtë dhe pa rëndësi për çështjen.

Paditësi paraqiti në gjykim disa akte shkresore për ti bërë të ditur gjykatës së nuk është hetuar në drejtim të verifikimit të vjetërsisë në punë si avokat. Kolegji e ka të qartë se nuk mund të vlerësojë nëse provat që solli paditësi në gjykim, do të ndikojnë në vendimmarrjen e organit administrativ, por në këndvështrimin e verifikimeve të pretendimeve të paditësit për shkelje të rëndë të procedurës që konsiston në mosezaurim të hetimit administrativ nga organi administrativ, kolegji nuk mund të mos iu referohet këtyre akteve për të kuptuar nëse procedura e hetimit ka qenë apo jo e plotë dhe shteruese. Kështu, në gjykim u paraqit një vërtetim nga dhoma kombëtare e avokatisë që vërteton se paditësi ka pasur një licensë aktive deri në vitin 2014, dhe një vendim gjyqësor ku paditësi rezultoi të jetë avokat mbrojtës i të gjykuarit.

Këto të dhëna të marra prej vetë paditësit në institucionet publike si Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, tregojnë se pala e paditur në funksion të konkluzionit të arritur prej vetë asaj se, *ushtrimi i profesionit të "avokatit" në kuptim të pikës 4 të Nenit 125 të Kushtetutës apo në pikën 2 të Nenit 7/a të ligjit Nr. 8577/2000 nënkupton jo vetëm pajisjen me licencën e avokatit, por edhe ushtrimin real të këtij profesioni*, e ka kufizuar padrejtësisht dhe fazën e hetimit administrativ lidhur me kriterin përvojë profesionale.

Sikurse u theksua me sipër, jo vetëm për faktin e regjistrimit apo jo të paditësit në institucionet e QKB dhe tatime pala e paditur duhej të kërkonte informacion kryesisht, por në kuadër të verifikimit të plotë të ushtrimit efektiv të profesionit të avokatit, hetimi mund të zgjerohet edhe me tej me qellim paraqitjen e të gjitha fakteve në mbledhjen e Këshillit dhe ai të vlerësonte për lejimin apo ndalimin e kandidimit.

Për sa më sipër, në vlerësim të këtij kolegji, shkeljet në procedurë në aspektin e verifikimit shterues të kriterit përvojë profesionale kanë qenë të tilla sa që kanë cenuar rëndësitë drejtën e kandidatit për të pasur një vendim të bazuar në fakte, si i tillë akti administrativ vendim Nr. 35 datë 09.10.2020 i Këshillit të Emërimeve në Drejtësiduhet të shfuqizohet si një akt i pavlefshëm.

Në lidhje me kërkimet për: *"Konstatimin e shkeljes në neneve 6, 8, 14, 17 të KEDNJ si rezultat i ndalimit të kandidimit për anëtar të GJK. Detyrimin e palës së paditur, KED të përfundojë procedurën për kandidatin [redacted] për vakancën e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019"*, kolegji vlerëson se për këto kërkime duhet të vendoset pushimi i gjykimit për faktin se kërkimet e parashtruar nga pala paditëse nuk janë objekt gjykimi nga kjo gjykatë, pasi sikundër u citua më sipër në këtë vendim, Gjykata Administrative e Apelit investohet në këtë lloj gjykimesh me natyrë të veçantë si gjykatë e shkallës së parë, juridiksion fillestar, për shkak të ligjit nr. 115/2016, nenit 238, për vendimet e ndalimit të kandidimit, dhe vetëm për shkelje të rënda të procedurës. Në kushtet kur KED vepron si organ kolegjal, është në diskrecionin e tij marrja e vendimit të kandidimit të kandidatit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

Për këtë shkak ky është një kërkim që nuk mund të parashtrohet përpara kësaj gjykate për pasojë padia në lidhje me këto kërkime duhet të pushohet si një kërkim që nuk mund të ngrihet në bazë të germës "c" të nenit 299 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të nenit 40, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, neni 238 i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”

VENDOSI

- Pranimin e pjesshëm të padisë.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 35 datë 09.10.2020 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
- Pushimin e gjykimit në lidhje me kërkimet e tjera.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
- Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

U shpall në Tiranë, sot më datë 06.11.2020

GJYQTAR

GJYQTARE

GJYQTAR

BARI SHYTI

ENKELEJDA METALIAJ (SOFTA)

KASTRIOT SELITA

d.v

d.v

Kundër

d.v

Vërtetohet nësë me originalin

